



METODOLOGJI

MBIKËQYRËSE/VLERËSUESE (Watchdog)

MJEDISORE DHE PËR BURIMET NATYRORE NË

KUADRIN E QEVERISJES LOKALE



Kjo metodologji (Watchdog) është përgatitur në kuadër të projektit “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”, me mbështetjen financiare të LëvizAlbania, një projekt i Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC).

Metodologjia u vjen në ndihmë Organizatave të Shoqërisë Civile dhe të rrjetëzimeve lokale dhe do të shërbej si bazë për të përgatitur programe vlerësimi/monitorimi pas prioritizimit të problematikave kryesore të identifikuara si më të nevojshme, për t’u adresuar në organet përgjegjëse në nivel lokal.

Gjithashtu, do të shërbej edhe për hartimin e strategjisë së advokimit, të cilën do të synojnë të zbatojnë në vijimësi.

Përmbajtja e metodologjisë është përgjegjësi e INCA dhe autorëve, si dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Publikuar nga:

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA)

Rr. Islam Alla, Pall. IVEA, kati i 1, Tirana

Tel/fax: +355 42231437

<http://www.inca-al.org>

E-mail: info@inca-al.org

Copyright © **Instituti për Ruajtjen e Natyrës - Shqipëri (INCA)**, 2022

Të gjitha të drejtat për publikimin, shumëfishimin, kopjimin, përdorimin e informacioneve të plota apo të pjesshme janë të rezervuara nga INCA.

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e LëvizAlbania dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Tiranë, më 10 Maj 2022

PARATHËNIE

Metodologjia është përgatitur në kuadër të projektit “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”, me mbështetjen financiare të LëvizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Projekti synon të kontribuojë për ndërtimin e një qytetarie (lëvizje komunitare) aktive, partnere e njohur në procesin e qeverisjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm, në nivel lokal dhe kombëtar; të nxisë rrjetëzime kombëtare dhe lokale aktive, fuqizimit të rolit të Organizatave të Shoqërisë Civile (OShC-ve) dhe partneritetin mes tyre për ruajtjen e natyrës dhe të burimeve natyrore lokale.

Njëherazi, të rrisë dhe përmirësoj aftësitë e OShC-ve në angazhimin qytetar/komunitar dhe mediatik për analizimin, monitorimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor dhe politikave me qëllim përmirësimin e menaxhimit dhe ruajtjes së burimeve natyrore, nëpërmjet aktiviteteve advokuese/lobuese të OShC-ve, në luftën kundër korrupsionit dhe minimizimit të ndikimeve negative në keq menaxhimin e burimeve natyrore dhe zonave të mbrojtura mjedisore (ZMM), duke përdorur të drejtën për informacion dhe pjesëmarrje në procesin e vendimmarrjes së përgjegjshme që ndikon në miradministrimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore lokale.

Po kështu të inkurajojë bashkëpunimin midis OShC-ve dhe autoriteteve publike, komuniteteve lokale, mediave për bashkëpunimin dhe krijimin e partneritetit mes tyre, në programe pune afatgjatë për të siguruar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore lokale.

Qëllimi kryesor i metodologjisë është të rrisë njohuritë e OShC-ve në lidhje me hapat e realizimit të mbikëqyrjes/vigjilencës (watch-dogging) mjedisore në praktikë dhe të nxisë bashkëpunimin e një rrjetëzimi jo formal, për të realizuar vlerësimin dhe monitorimin e problematikave mjedisore në nivel lokal.

Metodologjia u përgatit pas një procesi të gjerë konsultimesh të koordinuar nga INCA dhe partnerët e projektit me organizatat lokale, institucioneve publike, përfaqësues të bashkive, biznesit, arsimit, ekspertë të fushës, etj. Kjo qasje, me pjesëmarrje të gjerë, mundësoi dhënien e ndihmës konstruktive gjë që ka kontribuar përmes shfrytëzimit të këndvështrimeve të ndryshme, përmes njohurive dhe përvojave të ndryshme në fushën e ruajtjes së mjedisit, natyrës dhe të përdorimit të burimeve natyrore.

Metodologjia parashton kuadrin dhe mjetet për të bashkërenduar dhe mbështetur zbatimin e duhur të tij dhe për të mbikëqyrur ecurinë e zbatimit të projektit dhe jo vetëm, por edhe për ta përdorur në veprimtaritë e OJF-ve në raste të tjera të ngjashme, duke vendosur në qendër të veprimtarive social-ekonomike vendore zhvillimin e qëndrueshëm, eficientin e burimeve natyrore dhe mbrojtjen e natyrës, duke i transformuar këto sfida në mundësi për komunitetin.

Kjo metodologji praktike ndihmon OShC-të në nismat e tyre, që të kenë ndikim të ashpër në abuzimet specifike ndaj mjedisit dhe burimeve natyrore, nga organet kompetente të qeverisjes, agjencitë ligj zbatuese, biznesi dhe çdo individ dhe se si duhet të përdorin mjete të përshatshme për përfshirjen e komunitetit dhe të palëve të interesit për të reaguar ndaj tyre dhe për t'i adresuar në organet përgjegjëse për përmirësimin e gjendjes.

Njëherazi, përcakton kuadrin për bashkërendimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e problematikave mjedisore të identifikuara në bashkitë përkatëse, ndërsa përgjegjësia kryesore për ruajtjen e mjedisit dhe të burimeve natyrore u takon autoriteteve publike qendrore dhe vendore si dhe me përpjekjet e bashkërenduara të të gjithë aktorëve.

Në këtë kontekst OShC-të duhet të gjejnë dhe të kërkojnë bashkëpunimin e zyrtarëve kryesorë dhe të agjencive publike, me ndikim, të cilët janë mbështetës për kauzën që ndërmarrin. Pasi trajtimi i joefikasitetit, paaftësisë ose korrupsionit ka të ngjarë të shkaktojë kundërveprime të forta nga zyrtarët dhe strukturat përdoruese që kundërshtojnë këtë kauzë. Andaj, mbështetja e tyre, shoqëruar me reforma, është shpesh thelbësore nëse masat e promovuara do të jenë të suksesshme.

Ndërkohë ndjekja në vijimësi e programeve dhe masave të paracaktuara dhe gjatë zbatimit të tyre, është thelbësore për të arritur një ndikim të qëndrueshëm. Veprimet e njëhershme mund të jenë shumë efektive, por për të arritur një ndryshim të qëndrueshëm në kulturën burokratike dhe sjelljen përkatëse të strukturave dhe zyrtarëve publikë duhet edhe një përpjekje e qëndrueshme, duke përfshirë ngritjen të kapaciteteve, të advokimit për aksione komunitare dhe reagimit të OShC-ve dhe rrjetëzimeve lokale, për ruajtjen e mjedisit dhe të burimeve natyrore.

Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, në vendin tone, ende nuk është i integruar si duhet në politikat kombëtare dhe veçanërisht në ato lokale. Mos përfshirja e komunitetit dhe OShC-ve në vendimmarrjet lokale vjen përgjithësisht si rrjedhojë e kapaciteteve të ulëta dhe mungesës së njohurive në grupet e komunitetit lokal dhe mungesës së koordinimit mes OShC-ve e rrjetëzimeve që i përfaqësojnë.

Në këtë kontekst disa OShC po i adresojnë çështjet e ruajtjes së natyrës dhe të burimeve natyrore përmes projekteve dhe programeve, të cilat janë bërë pjesë e punës së tyre, duke përfshirë mbikëqyrjen në të gjitha planet e tyre strategjike. Në thelb përdorimi strategjik është për të ndikuar në politikat e fushës së ruajtjes të natyrës dhe një përpjekje për të përmirësuar cilësinë e jetës së komuniteteve.

Shpesh politikat lokale e kombëtare, për të mbrojtur natyrën dhe burimet e saja, mungojnë, janë joefektive ose nuk zbatohen. Në këtë kuadër mbikëqyrja është procesi i qëllimshëm i ndikimit të atyre, të cilët marrin vendime për zhvillimin, ndryshimin dhe zbatimin e politikave, në këtë drejtim:

- Mbikëqyrja e OShC-ve, në rastin tonë, fokusohet në çështjen e mirëqeverisjes së mjedisit, natyrës, ZMM-ve dhe të përdorimit të balancuar të burimeve natyrore.
- Roli i OShC-ve është të lehtësojë ose të krijojë ura mes komuniteteve dhe institucioneve lokale, qeverisë qendrore, parlamentit, etj, të qasjes së një mbledhësi për promovimin e dialogut që rezulton në përmirësimin e politikave dhe të legjislacionit pro natyrës.
- Për OShC-të, mbikëqyrja është mjete me të cilin duhet të ndikojnë vendimmarrësit, ndërsa politika është përmbajtja, atë që duam të ndryshojmë.

Njëherazi, komunitetet lokale nuk janë të mirë informuar mbi mundësitë e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, si potenciale për zhvillimin dhe mirëqenien e tyre. Aktualisht, kjo situatë pengon zbatimin efektiv të politikave lokale të ruajtjes së mjedisit dhe natyrës, duke sjellë menaxhim jo të mirë të burimeve natyrore.

Fuqizimi i zerit qytetar, përmes rrjetëzimit të OShC-ve lokale dhe kombëtare, mbetet një nga sfidat për përmirësimin e demokracisë së brishtë dhe zhvillimin e qëndrueshëm lokal e kombëtar. Kjo nismë do të forcojë legjitimitetin e rrjeteve lokale dhe zgjerojë hapësirën ndërvepruese të tyre, në veprime konkrete mbi çështje të zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore me rëndësi për komunitetet që ata përfaqësojnë në bashkitë e përzgjedhura.

Bashkia Lezhë, është përzgjedhur për arsyen se pjesë e territorit të saj është dhe Rezervati i Natyror i Menaxhuar/Park Natyror “Kune-Vain-Tale”, i cili përballet me dukuritë e erozionet detar, ndryshimeve klimatike, humbjen e habitateve dhe praninë e madhe e të larmishme të ndotjes etj. Lezha përfaqëson një komunitet aktiv të OShC, me vullnetin e mirë për bashkëpunim, por me dobësi në vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e rrjetëzimeve. **Organizata lokale “Klubi Ekologjik Lezhë” (KEL)** drejton një rrjet lokal me fokus mbrojtjen e ekosistemit “Kune-Vain-Tale”. Forcimi i këtij rrjeti mbetet një nevojë në vazhdimësi me qëllim rritjen e aktivizimit në adresimin e çështjeve mjedisore, pranë institucioneve përgjegjëse.

Bashkia Divjakë, mbulon territorin e parkut kombëtar “Divjakë-Karavasta” një nga ZMM më të rëndësishme në Shqipëri. Parku përballet me dëmtime, degradime, copëzim të habitateve dhe peizazhit në një masë të konsiderueshme. Nevoja për një bashkëpunim më të mirë ndër-institucional në nivel lokal dhe nxitja e një qeverisjeje gjithëpërfshirëse mbetet një problematikë që kërkon zgjidhje. Aktivizimi civil pranë kësaj bashkie është i dobët, i paktë në numër dhe shpesh herë i paorganizuar. **Organizata lokale “Horizont EU”**, me qendër në Lushnjë, është nxitur në krijimi i një rrjeti të OJF-ve (bashkia Divjakë dhe Lushnjë). OJF-të lokale ashtu edhe rrjeti përballen me problematika të vazhdueshme organizative dhe financiare, duke ndikuar edhe në aktivizimin e tyre si përfaqësues të komunitetit lokal. Kjo iniciativë do të synojë mbështetjen e mëtejshme për fuqizimin e tyre si dhe për rritjen e pjesëmarrjes në këtë rrjet veçanërisht të rinjtë dhe gratë fermere të bashkisë Divjakë.

Bashkia Has, përfaqëson një territor të pasur si me vlera të peizazhit dhe biodiversitetit malor dhe liqenor, ashtu edhe të pasurive natyrore që kërkojnë një menaxhim dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të tyre. Problematikat që hasen janë: dëmtime të peizazhit për shkak të minierave dhe gërmimeve, ndotje të ekosistemeve tokësore dhe ujore nga mbetjet urbane dhe rurale, aktivizim civil i brishtë dhe jo i organizuar. **Organizata lokale “Për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e Turizmit”** ka bërë disa përpjekje për krijimin e grupimeve të OJF-ve lokale, të cilat kanë qenë aktive me kohë të pjesshme (për sa kohë ka pasur mbështetje financiare). Nëpërmjet kësaj iniciative synohet rrjetëzimi i organizatave dhe grupeve formale të interesit me fokus mbrojtjen e mjedisit/burimeve natyrore në territorin e bashkisë.

Në kuadër të projektit tashmë janë formësuar tri rrjete lokale të OShC-ve, që do të ndërmarrin vlerësimin e problematikave lokale dhe prioritizimin e tyre, me fokus si ruhen dhe përdoren burimet natyrore, pajtueshmërinë e transparencës, informimit dhe pjesëmarrjes publike në vendim-marrjen e pushtetit vendor në këtë kuadër, duke përdorur mjetin e mbikëqyrjes (watch-dog).

Vlerësimi do të realizohet duke u mbështetur tek modelet e parapara në këtë metodologji dhe mbi këtë bazë, rrjetet lokale do të ndërtojnë programe vlerësimi/monitorimi (watch-dog) dhe pas prioritizimit të problematikave kryesore të identifikuara, si më të nevojshme për t’u

adresuar, do të ndërtojnë edhe strategjinë e advokimit, të cilën do synojnë ta zbatojnë në vazhdimësi.

Të gjitha organizatat partnere të rrjetit edhe pse kanë njohuri dhe zhvilluar aktivitete në mbrojtje të çështjeve mjedisore, janë të painformuara dhe nuk kanë dijet e duhura për mbikëqyrjen/vëzhgimin mjedisore (në kuptimin e gjerë të termit watch-dogging), me procedurat formale dhe aq strikte në ruajtjen e profesionalizmit gjatë procesit të mbikëqyrjes së vërtetë mjedisore.

Përdoruesit e kësaj metodologji duhet të kuptojnë se nuk është vetëm një metodologji vlerësimi, por i njohurive të mbikëqyrësve/qeneve roje, dhe se si duhet bërë vëzhgimi mjedisor në të gjitha rrethanat e mundshme, në nivel komuniteti (vendor apo kombëtar), etj., për të mbikëqyrë diçka me interes publik. Në këtë kontekst, mbikëqyrja u referohet mbrojtjes së OJF-ve kryesore dhe rrjetëzimeve lokale të tyre, komunitetit që preken ose vuajnë problematikat në lidhje me interesat e tyre jetike, të mos cenimit dhe mospërdorimit në mënyrë efikase të mjedisit dhe burimeve natyrore.

Gjithashtu, metodologjia, ndihmon se si duhet t'i adresoni sfidat me të cilat do të përballeni në kërkimin e ndryshimeve që dëshironi; në rritjen e pjesëmarrjes në forume të ndryshme vendimmarrëse apo këshillimore, duke synuar përmirësimin e vendimmarrjes lokale për përdorimin e burimeve natyrore mbështetur në planet vendore të zhvillimit; rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe përcaktimi më i mirë i rolit të gjithë aktorëve në nivel vendor në procesin e hartimit dhe zbatimit të planeve vendore të mjedisit.

Përmes kësaj metodologji tregojmë se sa i rëndësishëm është bashkëpunimi, shkëmbimi i informacionit lokal dhe debati kritik me qëllim përmirësimin e transparencës, llogaridhënies, pjesëmarrjes në vendimmarrje, të procesit të informimit, të efektivitetit në zbatimin e programeve e kuadrit ligjor, të përfshirjes komunitare/qytetare në luftën kundër korrupsionit si dhe rritjes së njohurive të publikut mbi vlerat e natyrës dhe rëndësinë e një menaxhimi të qëndrueshëm të burimeve natyrore, me mbështetjen e mediave.

Në këtë kuadër sfida për mbikëqyrësit është vëzhgimi, hetimi, analizimi, denoncimi dhe lufta kundër korrupsionit si dhe arritja e një ekuilibër mes raportimit për punën e mirë që bëhet në nivel vendi dhe raportimit për disa nga ato që nuk kanë funksionuar ose nuk funksionojnë mirë.

Nëpërmjet metodologjisë i jepet publikut dhe OShC-ve mjetet e nevojshme për të raportuar në mënyrën e duhur për problematikat dhe shqetësimet që adresojnë apo ndikojnë një individ, grup, apo OShC-të, etj, duke vlerësuar e monitoruar aktivitetet në emër të publikut, për të siguruar që njësia ekonomike, biznesi, përdoruesit e përfituesit apo/dhe strukturat publike, të mos sillen në mënyrë të paligjshme apo joetike, ndaj shqetësimeve dhe reagimeve të komunitetit.

Njëherazi, komunitetet/publiku, por edhe punonjësit publik, mediat dhe bizneset do të njohin më mirë se si punojnë OShC-të, nga të cilët përfaqësohet dhe do të mësojë rrugët se si vetë qytetarët mund të mbledhin informacionin, të jenë aktivë në vendimmarrje apo dhe të organizohen për të advokuar e lobuar për një çështje të caktuar.

Pra, metodologjia është zhvilluar duke marrë parasysh realitetin e bashkive në fjalë. Në këtë mënyrë si një mjet i dobishëm për vëzhguesit që dëshirojnë të hetojnë, analizojnë, vlerësojnë, ndërtojnë njohuri dhe edukojnë të tjerët mbi sukseset, sfidat dhe mësimet të zbatueshme për aktivitetet e tjera, synon të ndryshojë praktikatat negative të cilat dëmtojnë gjendjen e mjedisit dhe të burimeve natyrore në nivel lokal.

HYRJE.

Mbikëqyrja/Vëzhgimi (wachdogging) mund të konsiderohet si një evoluim i termit “qen roje” (watchdog) i cili, sipas fjalorit të gjuhës angleze, përkufizohet si “një qen që mbahet për të ruajtur pronën”. Më vonë ky term ka marrë edhe kuptime të tjera sikundër është ai i “një person ose grup personash që vepron si një mbrojtës apo kujdestar kundër praktikave jo efikase, të paligjshme, etj.” apo si folje “të zhbirilos me kujdes, aq sa të identifikosh sjellje jo të ligjshme ose jo etike. Fjalorë të tjerë mund ta përkufizojnë një person vigjilues si “dikush që ruan kundër humbjes, vjedhjes, apo praktikave të padëshiruara”.

Mbikëqyrja (Vëzhgimi) bëhet e rëndësishme në kontekstin shoqëror kryesisht në rastet kur ka një mungesë të dukshme vullneti nga qeveria për të zbatuar një grup ligjesh apo legjislacionin ekzistues në çdo nivel apo në rastet e mos zbatimit të standardeve të veprimtarisë nga një subjekt i caktuar, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së komuniteteve apo dhe në ekzistencën e burimeve natyrore.

E thënë kjo, mbikëqyrja/vëzhgimi, me fjalë të thjeshta, ka dy elementë të rëndësishëm në procesin e saj sikundër janë: 1) praktika e “zhbirimit” dhe 2) kërkesa e llogarisë që qytetarët i drejtojnë qeverisë dhe biznesit, të cilët me veprimtarinë e tyre kanë ndikim mbi jetën shoqërore, politike dhe mjedisin. Këta elementë i japin veprimtarisë mbikëqyrëse një mjet që zakonisht ndërmerret nga individë, por në rastin tonë nga OShC-të, të cilat quhen organizata mbikëqyrëse.

Mbikëqyrja nuk është e re. Shfaqja e organizatave mbikëqyrëse, siç ekzistojnë sot, është e rrënjosur thellë në zhvillimin e shoqërisë civile, në vendet e industrializuara, që nga vitet 1960. Ideja se të gjitha institucionet qeveritare, duhet të vëzhgohen, është rrjedhojë e të menduarit demokratik në shoqëritë e hapura.

Qytetarët e lirë kanë të drejtë të dinë se çfarë po ndodh në vendet e tyre, veçanërisht në lidhje me çështjet publike dhe që kanë ndikim të drejtpërdrejtë tek ata. Përtej kësaj, ka të bëjë me dëshirën për të treguar historinë, për të ndryshuar diçka, për të ndaluar diçka ose për të bërë diçka që nuk është kryer.

Organizatave vëzhguese zakonisht janë grupe jofitimprurëse, të cilët e shikojnë rolin e tyre si monitorues kritik të aktiviteteve të qeverisë, biznesit ose të agjencive të tjera dhe nxisin publikun për reagime, kur identifikojnë veprimtari që shkojnë ndesh me interesat e tij.

Mbikëqyrësit mund të shqetësohen nga çdo gjë, duke filluar nga veprimtaria e një individi deri tek politikat e qeverisjes vendore dhe kombëtare. Ata mbikëqyrin/hetojnë një çështje ose disa; shqetësimet të cilat mund të jenë lokale a kombëtare ose të dyja bashkë.

Në thelb, mbikëqyrja është **ushtrimi i presionit nga ana e qytetarëve përballë pushtetit të qeverisjes**. Mbikëqyrja është një mjet për pjesëmarrjen reale të komuniteteve në vendimmarrjet lokale apo/dhe nga organe të tjera. Në të njëjtën kohë, duhet të shkojë përtej angazhimit të komuniteteve për të përfshirë qytetarët dhe jo-qytetarët. Në këtë rast duhet të konsiderohet si: Akti i dhënies së mbështetjes për një politikë dhe bindjen e atyre që kanë kompetenca e përgjegjësi për të vepruar në mbështetje të politikës, në nivel lokal dhe kombëtar.

Kur flasim për mbikëqyrje dhe vëzhgues mjedisore nuk nënkuptojmë një proces të ndryshëm me përkufizime dhe parimet e tjera. Përcaktori “mjedisor” vetëm specifikon fushën e veprimtarisë mbikëqyrëse. Në këtë rast vigjiluesit ndjekin politikat dhe legjislacionin mjedisor, ndikimin në mjedis dhe të veprimtarive të subjekteve të ndryshme etj.

Mbikëqyrës lokal i referohet kujtdo në nivel komuniteti që dëshiron të mbikëqyrë diçka me interes publik, për të vëzhguar, monitoruar, vlerësuar, zbuluar, hetuar, analizuar dhe raportuar, në mënyrën e duhur, veprimtaritë dhe sjelljet e padëshiruara të qeverisjes vendore, aktet ose problemet e paligjshme, si dhe duke siguruar që të mos abuzojnë me pozitat e tyre privilegje në kurriz të komunitetit.

Në këtë kuptim, sfida për mbikëqyrësit është të arrijnë një ekuilibër midis raportimit për punën e mirë që po bëhet në nivel vendor dhe raportimit për disa nga ato që nuk kanë funksionuar ose nuk funksionojnë mirë.

Janë të shumtë faktorët që ndikojnë në përkeqësimin e situatës mjedisore në vendin tonë, analiza e të cilëve do të kërkonte një raportim të përcaktuar, megjithatë vlen të përmendet se mungesa e organizimit të qëndrueshëm të OShC-ve në aktivitete mbikëqyrëse luan rolin e saj të patjetërsueshëm.

Komuniteti i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile (OMShC-ve) në Shqipëri, fillesat e aktivizimit i ka në vitet 1990 (Krijimi i organizatës PPNEA), të nxitur nga problematikat mjedisore të shumta, të një vendi në zhvillim, por edhe nga interesi dhe mbështetja e institucioneve dhe shoqatave joqeveritare të huaja, donatorëve të ndryshëm etj. Shumë organizata në vend filluan të konsolidohen dhe të jenë të pranishme dhe aktive në problematikat mjedisore të vendit me mekanizma transparent dhe të paanshëm, por sërish, kjo nuk ka ndryshuar dukshëm mjedisin shqiptar.

Fillimet e para të vigjilencës së mirëfilltë mjedisore në Shqipëri (nëse mund të quhet e tillë,, pasi kryesisht ka qenë një reagim i OJF-ve dhe i komunitetit, pa një strategji të mirë hartuar si dhe e mungesës së njohurive për watch-doggin) kanë ndodhur me rastin e TEC (Vlorë) në viteve 2002-2006 dhe krijimi i “**Aleanca për mbrojtjen e Vlorës**”. Në atë kohë ende nuk ishte konsoliduar legjislacioni mjedisor i të drejtave të publikut për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrje, ndërkohë ishte ratifikuar Konventën e Aarhus-it, e cila u përdor nga protestuesit. Motoja e aleancës ishte se me ndërtimin e TEC-it, Vlora do të kthehej në një qytet nafte, ku bëhet fjalë për industri nafte, energjia është në shërbim të naftës dhe se për këtë projekt nuk janë pyetur qytetarët vlonjatë. Fakti është se ky projekt ishte një dështim i kushtueshëm i financuar nga Banka Botërore. Por, kjo lëvizje, ndonëse jo mirë e organizuar dhe në mungesë të një platforme, tërhoqi vëmendjen e publikut dhe të qeverisë si dhe krijoi një mendësi të re për protestat mbarë publike dhe riorganizimin e tyre.

Po kështu, “**Aleanca Kundër Importit të Plehrave**” (AKIP), përbëhej nga një grup intelektualësh, shoqatash nga shoqëria civile si dhe një numër i konsiderueshëm qytetarësh. Qëllimi kësaj aleance ishte ndalimi i importit të plehrave në Shqipëri, duke kërkuar edhe rishikim e disa neneve të ligjit për menaxhimin e mbetjeve të integruara. Shqetësimi i aleancës ishte se lejimi i këtyre importeve bie ndesh me strategjinë kombëtare për zhvillim të qëndrueshëm, shpesh flitet edhe për zhvillim të turizmit nga qeveritë tona dhe ligje të tilla bien

ndesh me këto objektiva që janë shpallur strategjike dhe kombëtare nga vetë qeveritë që i miratojnë këto ligje. Si rrjedhojë e një proteste masive të kësaj lëvizjeje në Tiranë, Vlorë, Elbasan etj, qeveria anuloi importin e tyre.

Në Shqipëri, gjatë kësaj periudhe 30-vjeçare, nga shumë grupime dhe OShC janë ndërmarrë veprime konkrete dhe të rritjes së përgjegjësisë për mbrojtjen e natyrës, të burimeve dhe të peizazhit natyror. Rasti i **“Grupimit të mbrojmë lumenjtë”** prej kohësh ka ngritur zërin për të mbrojtur dhe shfrytëzuar në mënyrë të qëndrueshme burimet ujore të vendit dhe kryesisht ato të lumenjve. Jemi dëshmitar të një sulmi të pa precedent që i është bërë rrjetit hidrik të vendit, ku janë dhënë mbi 540 leje shfrytëzimi për ndërtimin e hidrocentraleve, me një përfitim tepër minimal energjetik, në raport me dëmin mjedisor që ato shkaktojnë.

Protesta të fuqishme janë bërë për Vjosën, Langaricën, Bençën, Poçemin, Valbonën, Shebenikun, Lumën, Korabin, Cemin, Shalën, Shkumbinin, Devolli, Osumin, etj., etj.

Kundërshti ndaj HEC-ve kanë edhe banorët, të cilët thonë se projektet nuk janë konsultuar me komunitetin dhe rrezikojnë të ardhurat e tyre të bazuara tek turizmi malor. Në këto protesta janë bashkuar edhe aktivistë mjedisorë, personalitete të të gjitha fushave, shqiptarë që kanë emigruar dhe turistë e agjenci turistike nga mbarë bota, që e kanë futur udhëtimin në ZMM si një prej destinacioneve të tyre kryesore.

Përpjekjet e këtij grupimi, ndër të tjera, u përqendruar edhe në informimin e komuniteteve lokale dhe organeve vendore mbi vlerat dhe risqet potenciale të ndërtimit të hidrocentraleve, duke publikuar udhëzues për investitorët dhe institucionet shtetërore, duke kryer studime me karakter lokal e kombëtar, zbatuar miniprojekte për ndërgjegjësimin e komuniteteve lokale, por edhe duke kërkuar në forma dhe mënyra të ndryshme reagimin e organeve shtetërore.

OShC-të apo/dhe OJF-të e vogla mundohen të jenë aktive në komunitetin e tyre, ndërmarrin nisma të përbashkëta me partnerët lokalë; janë ende jo të konsoliduara mirë, por bëhen më aktivet kur krijojnë rrjetëzim apo koalicione me partnerë të besueshëm. Këto OShC çojnë përpara çështjet lokale dhe kombëtare, sipas prioriteteve, përmes rrjetëzimit dhe veprimeve të përbashkëta.

Rrjetet e formësuar, konsiderohen si një formë organizimi i qëndrueshëm, por ende nuk janë praktikë e punës së organizatave mjedisore në vend, pasi lidhen kryesisht edhe me mbështetjen financiare.

Rrjetet tematike adresojnë në mënyrë profesionale politikat mjedisore dhe njihen si aktorë të rëndësishëm nga ana e autoriteteve shtetërore. Kësisoj në vitin 2013, me mbështetje të REC, në kuadër të programit SENiOR-A (Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri), financuar nga Qeveria Suedeze, Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) dhe 8 shoqatat: “Forumi i Liqenit të Shkodrës”, “Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmi”-Kukës, “Miqësia-Ulëz”, “PSEDA-ILIRIA”-Tiranë, “Qendra Adriatiku (me pas Flag Pine)”-Vlorë, “Mjedisore Zagoria”-Gjirokastër dhe “Green&Clean”-Korçë, krijuan **“Rrjetin për Mbrojtjen e Natyrës” (RrMN).**

Qëllimi i kryesor i këtij grupimi ishte:

- Forcimi i rolit të organizatave mjedisore të shoqërisë civile për ruajtjen e natyrës dhe rritjen e kontributit lokal në ruajtjen e zonave të mbrojtura dhe ekosistemeve të ujërave të ëmbla e habitateve detare;
- Forcimi i bashkëpunimit midis organizatave të rrjetit;
- Zhvillimi i iniciativave të qëndrueshme dhe mënyrave të reja për promovimin e vlerave lokale të zonave të mbrojtura dhe habitateve ujore.

Krijimi i këtij rrjetëzimi, ishte një eksperiencë e vlefshme dhe e çmuar, jo vetëm për anëtarët e rrjetit, por edhe për INCA. Përvoja shumë dimensionale cilësohet në rritjen e kapaciteteve brenda stafit të INCA, shkëmbimin e eksperiencave midis partnerëve, por mbi të gjitha veprimi, drejtimi i një rrjeti në nivel lokal dhe kombëtar, krijimi i produkteve dhe gjurmëve të vlefshme ishin eksperiencat më rëndësishme.

E veçantë e këtij grupimi ka qenë mënyra e komunikimit dhe e marrëdhënieve të ndërsjella për realizimin e programit të përgjithshëm, bazuar edhe në përvojën e bashkëpunimeve gjatë viteve të mëparshme, duke krijuar lidhje me organizata të tjera lokale në vend dhe në kufitare me Shqipërinë. Nëpërmjet tyre janë duke krijuar bashkëpunime të reja dhe njëkohësisht është forcuar veprimin në nivel lokal, por jo plotësisht sipas njohurive të watch-doggin.

Koncepti i organizimit në rrjet vazhdon të ngelet një mundësi shumë e mirë, për të vijuar përvojën e vlefshme dhe frytdhënëse të veprimit në nivel kombëtar dhe lokal, por që kërkon një mentalitet krejt të ri, pra përfshirjen dhe të mjetit të mbikëqyrjes së mjedisit dhe të burimeve natyrore, të siguruar përmes zbatimit të projektit “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”, me mbështetjen financiare të LëvizAlbania, një projekt i Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC).

Tashmë, krahas forcimit më tej të kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (pjesëtare të rrjetit), kërkohet që ato të jenë të afta të luajnë rolin e katalizatorit, për të garantuar pjesëmarrjen sa më të gjerë proaktive të komuniteteve lokale si në vendimmarrje ashtu dhe në ndarjen e përfitimeve që vijnë nga menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, duke kontribuar njëherazi në ruajtjen dhe promovimin e vlerave të larta të biodiversitetit që karakterizojnë natyrën shqiptare.

Gjatë kësaj periudhe u krijuan dhe funksionuan edhe rrjetet për tematikat:

1. “Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve mjedisore nëpërmjet “Teknikave të Vëzhguesve të Trajnuar”, me 7 organizata pjesëmarrëse;
2. “Informim - Komunikimi mbi politikat mjedisore për zhvillim të qëndrueshëm, me fokus të veçantë menaxhimit e mbetjeve urbane”, me 7 organizata pjesëmarrëse;
3. “Së bashku një sy për mjedisin”, me 7 organizata pjesëmarrëse.

Në vitin 2019, INCA zhvilloj projektin “**Fuqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile, për të promovuar mbrojtjen e natyrës në Shqipëri**”, me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian (BE), nëpërmjet programit “Mbështetje për kapacitetet e Shoqërisë Civile”.

Projekti përmirësoj dhe fuqizoj aftësitë, potencialin dhe rolin aktiv të OShC-ve e të partnerëve në analizën, monitorimin dhe advokimin e politikave dhe të zbatimit të ligjshmërisë me qëllim

përmirësimin e mbrojtjes së natyrës dhe rritjen e ndikimit të OShC-ve, në luftën kundër korrupsionit dhe minimizimin e ndikimeve negative në menaxhimin e burimeve natyrore dhe Zonave të Mbrojtura Mjedisore (ZMM); të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet OShC-ve dhe autoriteteve publike, komuniteteve lokale, mediave dhe të nxisë rrjetëzimin apo ndërtimin e partneriteteve mes tyre.

Njëherazi u krijua dhe rrjeti kombëtar **“Të Advokojmë për Ruajtjen dhe Promovimin e Natyrës Shqiptare”**, me 4 OJF-t partnere: Horizont EU-Divjakë, PPNE-Vlorë, KEL-Lezhë dhe Agri-En-Librazhd, duke përfshirë 15 OJF lokale. Nëpërmjet këtyre grupimeve u synua të arrihet që OShC-të të forcojnë njohuritë, aftësitë dhe kapacitetet e tyre për t'u angazhuar në advokim-lobim dhe në proceset vendimmarrëse me një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse, efektive dhe të barabartë të të OShC-ve dhe aktorëve të tjerë kryesorë joqeveritarë, për ruajtjen dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura, duke përmirësuar aftësitë e tyre organizative dhe rrjetëzuese.

Në kuadër të këtij projekti INCA synoj dhe krijoj **“Forumi lokal mjedisor”**, për të ngritur rrjetin e këshilltarëve lokal, për një qasje më të mirë të ruajtjes së natyrës, përmirësimin e menaxhimit të ZMM dhe të mirë përdorimit të burimeve natyrore; për identifikimin e mangësive dhe të ndikimeve negative, të informimit të publikut si dhe të rritjes së reagimit të tyre ndaj strukturave shtetërore, qendrore e lokale, përgjegjëse për gjendjen e krijuar. Forumi shërbeu si një strukturë lokale profesionale e gatshme për të marrë pjesë në proceset advokuese dhe këshilluese pranë strukturave vendore përgjegjëse për ruajtjen e natyrës dhe menaxhimin e burimeve natyrore.

Në zbatim të projektit **“Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”**, me mbështetjen financiare të LëvizAlbania, një projekt i Agjencisë zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC), krahas forcimit të rrjeteve të krijuara më parë në Divjakë dhe Lezhë, u shtua dhe rrjeti i Hasit.

Organizatrat partnere, përfaqësojnë organizata mjedisore të cilat veprojnë në nivel lokal dhe ndikojnë me politikën dhe aktivitetet e tyre në nivel kombëtar. Sukseset e deri tanishme në dukje nuk janë të vogla, por arritjet e vërteta lidhen me forcimin e zërit qytetar dhe nxitjen e institucioneve qeverisëse për zbatueshmërinë e ligjit.

Veprimeve konkrete për mbrojtjen e natyrës dhe të burimeve natyrore janë ndërmarrë dhe nga koalicioni **“Stop Urbanizimit të Parkut Kombëtar “Divjakë-Karavasta”** prej 25 OJF, kombëtare e lokale, për mbrojtjen e PK “Divjakë-Karavasta”, të cilët reagojnë dhe kanë bërë publik shqetësimin e tyre mbi ndërhyrjen jashtë çdo kriteri mjedisor në parkun kombëtar dhe pezullim të procesit të miratimit të projektit “Divjaka Resort Albania”.

Protesta e Zagorisë nuk ishte vetëm reagim i shumë shoqatave dhe **“Forumi për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore”**, por kryesisht shqetësim dhe kundërshti e shumë banorëve të zonave të luginës së Vjosës, kundër kompanisë Shell dhe qeverisë shqiptare, që të mos kryejnë gërmime për të verifikuar nëse ka burime hidrokarburesh, dhe kërkojnë që të saktësojnë se nuk do të lejohet të preket parku i Zagorisë.

Një grupim i OShC-ve lokale dhe kombëtare kanë bërë dhe po bëjnë reagime për ndërtimin e **aeroportit të Nartës**, që do të shoqërohet edhe me ndërtimin e infrastrukturës shtesë, duke

përfshirë hotele dhe resorte, zona rezidenciale dhe hapësira sportive, do të tjetërsojë një sipërfaqe të konsiderueshme brenda zonës së mbrojtur dhe pashmangshmërisht, do të shkatërrojë një sërë habitatesh natyrore.

Grupimi mendon dhe argumenton shkencërisht se kërcënohet në tërësi integriteti ekologjik, jo vetëm i Zonës së Mbrojtur Vjosë-Nartë, por i gjithë ekosistemit ligator Shkumbin-Seman-Vjosë, deri në veri të qytetit të Vlorës. Njëherazi investimi në fjalë, bie në kundërshtim me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar për ruajtjen e natyrës.

Po ashtu, grupimi i kërkon qeverisë shqiptare se duhet të tregojnë kujdes të veçantë në të gjithë sektorin e investimeve strategjike, në mënyrë që këto të fundit, të jenë në pajtim të plotë jo vetëm me kuadrin ligjor vendas, por edhe me detyrimet që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, në mënyrë që të mos pengohet apo vonohet integrimi i vendit në Bashkimin Evropian.

Shqipëria po hyn në një fazë të rëndësishme për përgatitjen për negociatat e integritit në BE. Roli i shoqërisë civile konsiderohet thelbësore dhe e pashmangshme për të gjithë procesin, jo vetëm në mbështetjen e tij, por edhe në përcjelljen e mesazheve të duhura për publikun e gjerë, d.m.th. burimet e shoqërisë civile dhe monitorojnë atë nga perspektiva e rolit të shoqërisë civile.

Shqipëria po përparon drejt përbushjes së kushteve për të nisur procesin e negociatave me BE-në. Është e ditur dhe pranuar që **Kapitulli 27: “Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike”** është një nga kapitujt më kompleksë, ku aktorë të ndryshëm të shoqërisë duhet të përfshihen dhe të kontribuojnë.

Partnerët kryesorë të grupimit **GREEN 27+** janë: Qendra Burimore e Mjedisit (REC Shqipëri), Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (Qendra EDEN), Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) dhe Instituti i Kërkimeve Urbane (URI), të cilët u angazhuan dhe zhvilluan një program mbështetjeje dhe rritje kapacitetesh për shoqërinë civile, duke synuar përmirësimin e procesit të integritit të Shqipërisë në BE, duke nxitur dialogun midis institucioneve qeveritare dhe OShC-ve për legjislacionin mjedisor.

Grupimit **GREEN 27+** me mbështetjen e 20 organizatave mjedisore nga i gjithë vendi, si program i parë pilot, ishte një kontribut i ngritur për procesin, duke zhvilluar dhe artikulluar pozicionin e OShC-ve në negociatat BE-Shqipëri, në lidhje me temat e Kapitullit 27. Në mënyrë që të maksimizohen rezultatet e prekshme të raportit, nënkaptujt tematikë të mëposhtëm u identifikuan si fokus prioritar: 1. Legjislacioni horizontal; 2. Mbetjet; 3. Uji; 4. Ruajtja e natyrës.

Grupimi **GREEN 27+** me përfundimin e projektit besoi fuqimisht në rolin e rëndësishëm që shoqëria civile mjedisore shqiptare mund dhe duhet të luajë në procesin e negociatave me BE-në, një rol vendimtar dhe të pashmangshëm në të gjithë këtë proces.

Nga ana tjetër, gjendja aktuale e gatishmërisë institucionale për negociatat me BE-në tregoi një hapësirë të kufizuar për përfshirjen e shoqërisë civile. Kjo, kryesisht për shkak të mungesës së mënyrave, njohurive për përfshirjen e OShC-ve, si dhe informacionit të kufizuar teknik mbi vetë procesin e negociatave me BE-në. Sidoqoftë, OShC-të mjedisore shqiptare po luajnë gjithnjë e më shumë rolin e tyre mbikëqyrës në zhvillimin e politikave, përbushjen e

kërkesave dhe zbatimin e ligjit, të drejtën për të marrë informacion dhe pjesëmarrjen publike, etj.

Gjithashtu, procesi i arritur vlen si një mjet për të kuptuar proceset e përafrimit dhe negociatave me BE-në, në një moment kyç për zhvillimin dhe rritjen e lëvizjes së OShC-ve në Shqipëri, duke synuar marrjen e pozicionit të ekspertit për të mbrojtur disa përparësi mjedisore. Një shoqëri civile më e fortë rezulton në një qeverisje më të mirë, duke identifikuar zgjidhjet duhura në arritjen e kërkesave të BE-së për mjedisin, si dhe duke ndihmuar institucionet e vendit në përmbushjen e përgjegjësiave të tyre.

Përfshirja në proces e GEEN27+ u përqendrua në sigurimin e opinionit dhe raportit alternativ të progresit, përmes vlerësimit të progresit të vendit në sektorët e synuar. Veç kësaj kontribuoi në rritjen e kapaciteteve dhe rrjetëzimin e OShC-ve; aktivitete të ndryshme u përdorën për të rritur kapacitetet e ekspertëve të OShC-ve në temat e negociatave me BE-në, si dhe për të ruajtur kanalet e komunikimit dhe dialogut midis autoriteteve dhe shoqërisë civile, në mënyrë që të rritet ndikimi i tyre në proceset e vendimmarrjes për aspektet e negociatave me BE-në.

Ndërtimi i një shoqërie civile në gjendje për të adresuar në mënyrë efektive sfidat mjedisore dhe ato të zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore në Shqipëri, mbetet një sfidë tepër e rëndësishme.

Të ndjeshëm mbi çështjet e të drejtave mjedisore dhe njohës të mirë të situatës së mjedisit dhe të përvojës së fituar, kryesisht nga OShC-të kombëtare, për analizimin dhe reagimin në lidhje me problemet mjedisore, në këto vite, del mëse e nevojshme riaftësimi i anëtarëve të OShC-ve dhe të rrjetëzimeve për një qasje më të re në misionin dhe punën e tyre.

Gjithashtu, kërkohet një ridimensionim i veprimeve të përbashkëta që shqetësojnë vendin dhe komunitetet, zhvillimi i qëndrueshëm pa cenuar vlerat sociale, ekonomike, turistike dhe të trashëgimisë natyrore e kulturore, etj. Për këtë duhet, të ri jetësojmë dhe zhvillojmë më mirë proceset organizimit, të rritjes së njohurive dhe të shpërndarjes së informacionit, të denoncimeve dhe reagimeve të përbashkëta, duke përfshirë më mirë komunitetet e mediat si dhe forcimin e mbikëqyrjes së mirëfilltë mjedisore dhe të burimeve natyrore.

1. RRETH MBIKËQYRJES (WATCHDOGGING)

Mbikëqyrja/Vëzhgimi përdoret për të përshkruar aktivitetet e OShC-ve, rrjetit të OJF-ve lokale dhe të atyre që do të vëzhgonin njerëzit, organizatat apo/dhe stafin dhe drejtuesit e qeverisjes vendore në pozicionet e influencimit të pushtetit, për të siguruar që ata të mos abuzojnë me pozitën e tyre të privilegjit në kurriz të publikut (ose mirëqenien e komunitetit të caktuar).

Mbikëqyrja/Vëzhgimi ndihmon në dhënien njerëzve dhe OJF-ve të mjeteve të duhura për të vëzhguar, monitoruar, zbuluar, analizuar, vlerësuar dhe raportuar në mënyrën e duhur veprimtaritë dhe sjelljet e padëshiruara të qeverisjes vendore; një mjet i dobishëm për vëzhguesit që ndërtojnë njohuri dhe edukojnë të tjerët mbi sukseset dhe sfidat.

Mbikëqyrja nuk është e re. Shfaqja e organizatave mbikëqyrëse, siç ekzistojnë sot, është e rrënjësor thellë në zhvillimin e shoqërisë civile, në vendet e industrializuara, që nga vitet 1960.

Ideja se të gjithë institucionet qeveritare duhet të vëzhgohen është pasojë e të menduarit demokratik në shoqëritë liberale. Qytetarët e lirë kanë të drejtë të dinë se çfarë po ndodh në vendet e tyre, veçanërisht në lidhje me çështjet publike dhe problemet që kanë ndikim të drejtpërdrejtë tek individët dhe komuniteti.

Mbikëqyrja/Vëzhgimi bëhet e rëndësishme në kontekstin shoqëror kryesisht në rastet kur ka një mungesë të dukshme vullneti nga qeveria për të zbatuar një grup ligjesh apo legjislacionin ekzistues në çdo nivel apo në rastet e mos zbatimit të standardeve të veprimtarisë nga një subjekt i caktuar, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së komuniteteve dhe në mjedisin natyror.

Mbikëqyrja publike është ndër të tjera dhënia njerëzve të mjeteve të duhura për të raportuar në mënyrën e duhur nëse një shërbim i monitoruar është i dobishëm apo abuziv, nga aktivitetet e një individi, biznesi, grup jofitimprurës dhe organeve qeveritare, në emër të publikut dhe për të siguruar që ata të mos sillen në mënyrë të paligjshme ose joetike.

Mbikëqyrja është veçanërisht e zakonshme ku qeveritë janë, në parim, demokratike dhe transparente. Për t'i mbajtur ata përgjegjës ndaj një grupi të lartë standardesh për qeverisjen, transparencën dhe efikasitetin, ku organizatat mbikëqyrin sektorin publik, sektorin e biznesit dhe mjedisin.

Nga mbikëqyrja përfiton publiku. Një kulturë e mbikëqyrjes kultivon një mjedis ku individët marrin përgjegjësinë për shërbimin publik. Mbikëqyrësit më të mirë e bëjnë këtë në mënyra që zgjerojnë konsensusin dhe inkurajojnë standarde të larta; ka të bëjë me balancimin e të kuptuarit se çfarë është mbikëqyrja dhe realitetit (duke parë shembuj të një vëzhgimi të tillë dhe rezultatet). Bëhet fjalë për mbajtjen përgjegjëse të institucioneve apo njerëzve dhe kjo mund të bëhet në mënyra të ndryshme në varësi të asaj që synon të arrijë mbikëqyrësi.

Fushat kryesore ku mund të mbikëqyrin organizata apo vëzhguesi janë: Qeverisja qendrore dhe vendore; Biznesi; Mediat; Mjedis; Liritë dhe të drejtat civile; Siguria publike, Çështjet e konsumatorit dhe të mirat publike të përgjithshme.

1.1. ÇFARË ËSHTË NJË WATCHDOG (QEN ROJE)?

Përkufizohet, në përgjithësi, si një person ose grup personash që vepron si mbrojtës, kujdestar ose vëzhgues kundër joefikasitet, praktikave të paligjshme ose praktikave të tjera të padëshirueshme dhe kërkon të mbrojë të drejtat e njerëzve/komunitetit.

Në praktikën ndërkombëtare (kryesisht në Shtetet e Bashkuara dhe në Evropë) konsiderohet si një evoluim i termit “qen roje” (watchdog), i cili, sipas fjalorit të gjuhës angleze, përkufizohet si “një qen që mbahet për të ruajtur pronën”.

Sinonimet e “qen roje”: Mbikëqyrës, Vëzhgues, Vigjilues, Kujdestar, Mbrojtës, Rojtar publik, Monitorues, Patrullues, të gjitha këto bazuar në kontekstin e përdorimit dhe të veprimit.

Më vonë ky term ka marrë edhe kuptime të tjera sikundër është ai i “një person ose grup personash që vepron si një mbrojtës apo kujdestar kundër praktikave jo efikase, të paligjshme, etj” apo si folje “të zhbirilosh me kujdes”, aq sa të identifikosh sjellje jo të ligjshme ose jo etike. Fjalorë të tjerë mund t’a përkufizojnë një person vigjilues si “dikush që ruan kundër humbjes, vjedhjes, apo praktikave të padëshiruara”.

Një “qen roje”, po ashtu, siguron një kontroll ose ekuilibër brenda sistemit, duke punuar për të rritur efektivitetin dhe integritetin. Vëzhguesit hetojnë, zbulojnë, kontrollojnë, ekspozojnë, pyesin, marrin në pyetje dhe nuk besojnë derisa të zbulohet prova e së vërtetës.

Kësisoj, qëllimi kryesor i një “qen roje” është të mbështesë dhe përmirësojë efektivitetin e sistemit të monitoruar, në vend që ta kundërshtojë ose ta kontrollojë atë. Përpos kësaj ata mbikëqyrin qeverinë, biznesin, mjedisin dhe çdo fushë tjetër ku interesi publik është i kërcënuar.

Në kontekstin e kësaj metodologjie, për analogji me synimin tonë, konsiderohet: Një person, grup ose rrjetëzim OShC-ve që kryen vëzhgimin e vepron si kujdestar, mbikëqyrës dhe monitoron, publikon e raporton aktet dhe problematikat e paligjshme a korruptive apo edhe sjelljet e qeverisjes vendore, të përdoruesve e përfituesve nga burimet natyrore dhe të tjerëve.

Një mbështesë dhe kontrollues për zbatimin e legjislacionit dhe parandalimin e praktikave të paligjshme të ruajtjes, shpërdorimit e përdorimit jo të qëndrueshëm e joligjor, të praktikave jo tradicionale dhe joetike të burimeve natyrore, duke zbuluar, denoncuar dhe advokuar në emër të komunitetit.

Vëzhguesit mund të shqetësohen për çdo gjë, nga veprimet e një individi deri te politikat e qeverisë në nivel kombëtar a vendor; mund të monitorojë një çështje ose shumë; shqetësimet të cilat mund të jenë lokale, kombëtare ose për të dy nivelet. Në përgjithësi, qëllimi kryesor i një vëzhguesit është të mbështesë dhe përmirësojë efektivitetin e sistemit të monitoruar, në vend që ta kundërshtojë ose ta kontrollojë atë.

Ashtu si rojtarët aktualë, individët dhe organizatat vëzhguese ndryshojnë në atë që bëjnë. Për disa, vetëm tingëllimi i alarmit është qëllimi. Të tjerët mund të përpiqen të përdorin informacionin e tyre në mënyrë aktive për të shmangur problemet. Disa do t'i trajtojnë problemet ballë për ballë, duke hyrë në padi ose beteja të tjera të ngritura me individë ose institucione që ata i shohin si kërcënuese për interesin publik ose mirëqenien e komunitetit.

Ndërsa disa organizata mbikëqyrëse përqendrohen vetëm në atë funksion, shumë prej tyre kanë edhe qëllime të tjera, dhe përfshijnë rolin e mbikëqyrësit si vetëm një nga gjërat që bëjnë. Roli i mbikëqyrësit mbivendoset me atë të avokatit, por shtytja e shumicës së advokimit është avancimi i një kauze ose përmirësimi i kushteve për një komunitet ose zonë të caktuar gjeografike. Qëllimi i shprehur i vëzhguesve, arsyeja pse ata quhen “mbikëqyrës/qen rojtarë”, është mbrojtja.

Nga ana tjetër, organizata mbikëqyrëse apo/dhe vëzhguesit mund të llobojnë, të ndërmarrin veprime të drejtpërdrejta të ndonjë lloji ose të shkojnë në gjykatë për të ndaluar veprimet ose për të ndryshuar kushtet që rrezikojnë ose dëmtojnë komunitetin ose anëtarët e tij.

Me pak fjalë, një vëzhgues në nivelet lokale, mund të monitoroj thujse çdo çështje që ka një ndikim në politikë ose mirëqenien sociale, ekonomike dhe mjedisore të komunitetit.

Një organizatë mbikëqyrëse apo dhe rrjetëzimi i saj lokal mund të sigurojë të njëjtën mbrojtjeje për një komunitet dhe anëtarët e tij. Duke mbledhur dhe publikuar informacion dhe nganjëherë duke ndërmarrë veprime të drejtpërdrejta, të ekspozojë dhe adresojë çështje që lidhen me shëndetin, sigurinë ekonomike, mjedisin, cilësinë e jetës së komunitetit dhe interesin publik.

Sipas përvojës ndërkombëtare mund të veprojnë si vëzhgues/roje qen organizatat e interesuara për një çështje të caktuar, në lidhje me:

- Njerëz të prekur nga një çështje, ose organizata që i përfaqësojnë ata.
- Organizatat profesionale.
- Organizatat që përfaqësojnë interesin e përgjithshëm publik.
- Agjencitë, organizatat dhe individët e interesuar me pasojat ekonomike të politikave, praktikave dhe veprimeve.
- Ata që janë anëtarë të grupeve minoritare ose përfaqësojnë interesat e pakicave dhe duan të sigurohen që të mos diskriminohen dhe që shqetësimet e tyre të mos shpërfillen ose harrohen.
- Ata që merren me ruajtjen e idealeve demokratike.

1.2. KARAKTERISTIKAT E NJË MBIKËQYRËSI EFEKTIV LOKAL

Një vëzhgues efektivë duhet të karakterizohet si më poshtë:

- **I pavarur**, veprojnë në mënyrë bashkëpunuese, por në distancë nga të gjitha palët e interesuara;
- **Neutral**, ruajnë objektivitetin dhe saktësinë në gjithçka që bëjnë;
- **I dobishëm**, ndajnë praktikën më të mira dhe mësimet e nxjerra me të tjerët dhe partnerët brenda vendit;
- **I ditur**, të mësojnë për politikën dhe procedurat që duhet të ndjekin praktikën më të mira në hetimet e tyre;
- **I përgjegjshëm**, t'u përmbahen nevojave të njerëzve që i sjellin çështjet në vëmendjen e tyre;
- **Pjesë e zgjidhjes**, identifikojnë çështjet sistematike dhe bëjnë rekomandime të balancuara, të dobishme dhe të arritshme për të forcuar efektivitetin dhe përgjegjshmërinë e programeve dhe operacioneve të monitoruara në vendin e tyre;

- **Konfidenciale**, të mbrojtë identitetin e ankuesve dhe të mbajë në konfidencialitet materialet e ndjeshme;
- **Të vetëdijshëm për problemet e vendit**, mbikëqyrni se çfarë mund të pengojë ose të sigurojë një mjedis të përshtatshëm për vëzhgimin.

Vëzhguesit individualë mund të jenë jashtëzakonisht efektivë, për shkak të pasionit dhe njohurive të tyre, së bashku me kohën që i kushtojnë kauzës së tyre. Nëse merr një rol mbikëqyrës individual, sigurohu t'i kesh faktet e tua të drejta dhe se ajo që po vëzhgon është në fakt e rëndësishme për publikun.

Çfarë lloj “**roje qen**” duhet? organizata e përcakton në varësi të burimeve që disponon, përvoja dhe natyra e punës së saj, problematikat dhe subjektet që monitoron, kundërshtarët dhe sa përfshihet komuniteti për të pasur shumë gjasa të jeni efektiv në veprimet që ndërmerri.

Në një pjesë të madhe, mbikëqyrja lokale, do të përcaktojë pse veproni si roje edhe nga:

- **Interesi vetjak;**
- Për të mbrojtur dhe fuqizuar ata me pak **ndikim politik, ekonomik dhe social;**
- **Të ndërgjegjësohen qytetarët** për çështjet, veprimet dhe politikat që ndikojnë në jetën e tyre dhe në tërësinë e mjedisit ku jetojnë;
- Për të mbajtur pushtetin në duart e **komunitetit**, dhe jo të pakicave;
- Për të parandaluar pasojat **negative ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore;**
- Për të promovuar **drejtësinë sociale** ose ndryshimin shoqëror;
- Për të ruajtur idealet **demokratike** dhe për të arritur një **drejtësi të thjeshtë.**

Ndonëse çdokush mund të veprojë si roje, në çdo kohë që duket e nevojshme, ka njerëz dhe organizata që janë veçanërisht të përshtatshme për punën, dhe raste kur është veçanërisht e përshtatshme. Kandidatët e mirë për statusin e mbikëqyrësit përfshijnë organizatat e lidhura me çështjet ose subjektet në fjalë; personat e prekur, ose organizatat që i përfaqësojnë ata; organizatat përkatëse profesionale; organizatat që përfaqësojnë interesin publik; organizatat dhe individët e interesuar me pasojat ekonomike të politikave, praktikave dhe veprimeve; mbrojtësit e interesave të pakicave; dhe ata që merren me ruajtjen e demokracisë.

Vëzhguesit duhet ta paraqesin veten si profesionistë të respektuar dhe jo thjesht si aktivistë i një OJF-ve. Ata duhet të dinë të zgjedhin betejat e tyre dhe të gjejnë qasjen e duhur sipas rrethanave dhe audiencës së synuar. Përpjekjet e tyre duhet të lidhen me synimet dhe duhet të shihen si të paanshme.

Mbikëqyrësi mund të luajë rol të ndryshëm dhe që diktohen kryesisht nga mënyra se si një mbikëqyrës pozicionohet në nivel lokal, dmth duke qenë pjesë e çështjes/sistemit që monitoron/vëzhgon ose duke marrë pjesë nga jashtë sistemit.

Mbikëqyrësit vëzhgojnë qeverinë, organet dhe agjencitë e veçanta publike, biznese, organizatat, etj., për t'u siguruar që vendimmarrjet, projektet dhe veprimet e tyre të mos shkaktojnë dëm ose konflikt me interesin publik. Kur ata e gjejnë atë konflikt, mund të veprojnë si sinjalizues, duke ekspozuar ndaj publikut veprime ose praktika të paligjshme ose të tjera negative dhe duke pritur që ai ekspozim të sjellë masat e duhura apo/dhe një protestë publike. Përndryshe, disa mbikëqyrës mund të advokojnë e llobojnë apo të përfshihen në veprime të

drejtpërdrejta, të shkojnë në gjykatë për të denoncuar këto veprime ose për të ndryshuar kushtet që rrezikojnë ose dëmtojnë komunitetin ose anëtarët e tij.

Organizatat dhe rrjetëzimet mbikëqyrës zakonisht e shikojnë rolin e tyre si monitorues kritik të aktiviteteve të qeverisë, biznesit ose të organeve të tjera dhe nxisin publikun kur identifikojnë veprimtari që shkojnë ndesh me interesat e tij.

Shembujt e mbikëqyrësve mund të variojnë nga banori i thjeshtë që merr pjesë dhe informon në çdo mbledhje deri te organizata. Disa individë dhe organizata mund të monitorojnë veprimtarinë e qeverisjes qendrore e vendore si dhe bizneset për t'u siguruar që ata zbatojnë kuadrin ligjor në fuqi, nuk marrin vendime në mënyrë të paligjshme në mjedis, nuk dëmton burimet natyrore dhe nuk cenojnë jetesën e tyre. Po ashtu denoncojnë veprimet dhe kanë të drejtë për t'u mbrojtur kundër çdo vendimi ose praktike që nuk është në përputhje me të mirën e komunitetit.

Nëse flasim për mbikëqyrje dhe vigjilues mjedisorë nuk nënkuptojmë një proces të ndryshëm me përkufizime dhe parime të tjera, në lidhje me fushën e veprimtarisë. Në këtë rast ndjekin politikat dhe legjislacionin mjedisor, ndikimin në mjedis dhe të veprimtarive të subjekteve të ndryshme etj.

Me pak fjalë, OJF dhe rrjetëzimi i tyre mund të jenë një mbikëqyrës në nivel lokal dhe kombëtar, që mund të monitorojnë thujtse çdo problem dhe që mund të drejtoni vëmendjen apo aksionin thujtse te çdo grup përfitues të burimeve natyrore, bizneset, ose institucionet që kanë ndikim në mirëqenien sociale-ekonomike dhe politike të komunitetit.

1.3. PSE DHE KUR DUHET TË VEPRONI SI MBIKËQYRËS/VËZHgues?

Ka padyshim një sërë arsyes pse organizata dhe rrjetëzimi mund të veprojnë si mbikëqyrës. Shumica prej tyre kanë të bëjnë me kryerjen e veprimit dhe kauzës së duhur dhe t'i shërbejnë komunitetit, në kuadër të misionit dhe strategjisë të OShC.

Arsyet dhe momentet për të nisur një proces mbikëqyrës janë të ndryshme dhe të ndërthurura nga shumë faktorë që ndikojnë në interesat e komuniteteve.

Ashtu si me shumicën e aktiviteteve të lidhura me politikat, funksionimi si mbikëqyrës është diçka që duhet bërë vazhdimisht nga thujtse të gjithë. Po ashtu siç ka njerëz dhe grupe që mund të jenë më efektivë si mbikëqyrës/vëzhgues se të tjerët, ka raste kur aktiviteti i mbikëqyrësve është veçanërisht i përshtatshëm dhe i dobishëm.

Këto veprime mund të ndërmerren në rastet:

- **Kur po kërkoni të krijoni ose ndryshoni ligje ose rregullore.** Aktiviteti **Watch-dog** është i dobishëm për të forcuar argumentet për ndryshimin që jeni duke mbrojtur. Këto mund të përfshijnë ligjet mjedisore, rregullat ose çfarëdo aktet nënligjore në drejtim të ruajtjes së natyrës dhe të burimeve natyrore, apo dhe të ndërlidhura me ligje të tjera.

Nëse mund të tregoni se një biznes po mashtron ose nuk zbaton ligjshmërinë në ruajtjen e mjedisit dhe të burimeve natyrore apo dhe rastet e korrupsionit, duhet të jeni në gjendje që të bindni ligjvënësit që të miratojnë ligje më të rrepta për të parandaluar që kjo të mos ndodhë.

- **Kur një projekt i ri po fillon ose do të fillojë,** dhe keni dyshime për ndikimin e tij,

pasi nuk janë respektuar kuadri ligjor, e drejta mjedisore për t'u informuar dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe do të ketë një ndikim mjedisor më shumë përtej asaj që është parashikuar, duhet që vëzhgimi juaj të tregoj se keni të drejtë, mund të argumentoni apo të shmangni ose ndryshoni projektin për të mënjanuar pasojat negative.

- **Kur beson se interesi publik është i kërcënuar** dhe se ligjet ose rregulloret veprojnë për të përfituar një individ ose grup të vogël në kurriz të pjesës tjetër të komunitetit; kur njësi ekonomike dhe qeverisja vendore është duke u angazhuar në praktika që kërcënojnë shëndetin, sigurinë, mirëqenien ekonomike, mjedisin veçanërisht në drejtim të komunitetit; duhet të argumentoni dhe të reagoni për të mbrojtur interesat më të mira të komunitetit.

- **Kur një njësi ekonomike ose individ, qeveri ose një zyrtar qeveritar, një biznes ose industri, një program shërbimi njerëzor, etj., ka rezultuar i pabesueshëm në komunitet.**

- **Kur merrni informacion për veprime ose praktika aktuale, të planifikuara ose të mundshme të dëmshme ose të dyshimta.** Në raste të tilla, nga një sinjalizues i besuar ose nga hetimet tuaja, vërehet se ka ndodhur një sjellje ligjore, se procedurat e përcaktuara nuk po ndiqen, një formë e padrejtësisë ka ndodhur ose ka të ngjarë të ndodh, pa pjesëmarrjen e komunitetit dhe të palëve të interesuara, kjo situatë duhet të denoncohet dhe hidhet dritë mbi praktikën e errëta, mbi transparencën dhe të parandalojnë korrupsionin dhe abuzimin me publikun. Për këtë mblidhni fakte rreth gjendjes aktuale të çështjes dhe/ose në lidhje me politikën dhe praktikën aktuale të subjekteve me të cilat jeni të shqetësuar.

2. GJURMIMI DHE CILAT JANË SYNIMET E VËZHGUESIT /MBIKËQYRJES?

Mbikëqyrja lokale mund të synojë çështje të ndryshme. Më poshtë janë shembuj të gjurmimit dhe hetimit të përdorimit të burimeve natyrore në nivele lokale:

a. **Raportimi, përshkrimi dhe shpjegimi**

Mbledhjen, analizën dhe shpërndarjen e informacionit përkatës në çfarëdo formati, tek audiencia përkatëse e synuar me mjete të ndryshme.

b. **Informacioni i verifikimit**

Rregullimi i të dhënave për çështje të rëndësishme të mbuluara në mënyrë të pasaktë qoftë në debate publike apo në media.

c. **Monitorimi/hetimi**

Gjurmimi i çështjeve përkatëse për të bërë përgjegjës ata që punojnë ose përdorin burimet natyrore të mbikëqyrura, ose ata që ndikojnë dhe përkrahin shpërdorimin e fondeve publike.

d. **Duke kritikuar**

Vlerësuar pikat e forta dhe të dobëta, duke dhënë lëvdata ku dhe kur duhet, duke ofruar kritika konstruktive aty ku është e dobishme.

e. **Advokim/aktivizëm**

Përdorimi i informacionit për të advokuar e aktivizuar komunitetin si dhe lobuar për çështje të caktuara tek vendimmarrësit përkatës në nivel lokal e kombëtar.

f. **Duke shërbyer si një kanal për sinjalizuesit**

Inkurajimi i njerëzve që janë të përfshirë drejtpërdrejtë në zbatimin ose mbikëqyrjen apo për të raportuar parregullsi për çështjet përkatëse, duke mbrojtur identitetin e tyre.

Është e rëndësishme që të keni një strategji specifike organizative, sociale e financiare që duhet të zgjidhni dhe të veproni për arritjen e synimit tuaj, nëpërmjet aktivizimit efektiv të disa rojeve gjatë procesit vigjilues dhe të përcaktoni se si t'i qaseni aktiviteteve të mbikëqyrjes së tyre.

Në këtë kontekst: A po synoni për një rezultat specifik, konkret dhe një ndryshim në të mirën e komunitetit?

Qëllimi juaj dhe përmbushja e tij mund t'ju ndihmojnë të vendosni se çfarë lloj mbikëqyrjeje do të kryeni.

Për këtë duhet të përcaktoni:

Cili është synimi?

- ✓ Për të mbajtur qytetarët në dijeni për atë që ndodh për qark, duke i dhënë komunitetit informacionin që ka nevojë për të kuptuar situatën dhe të fillojë ta rregullojë atë.

Veprimi që kryhet:

- Kur kërkojmë të përmirësojmë ose të ndryshojmë ligjet apo rregullore të ndryshme.
- Kur një projekt i ri ka filluar apo do të fillojë dhe keni dyshime rreth pasojave/ndikimit të tij.

Cili është synimi?

- ✓ Për të mbajtur fuqinë në nivelin e komuniteteve dhe të praktikojmë demokracinë.

Veprimi që kryhet:

- Kur besojmë se interesi i komunitetit kërcënohet.
- Kur një individ, qeveria, industria, biznesi, bujqësia, etj., ka dhënë prova në të shkuarën që nuk janë të besueshme.

Cili është synimi?

- ✓ Për të parandaluar pasoja negative. Adresoni çështjet që duhen rregulluar.

Veprimi që kryhet:

- Kur merrni një informacion rreth veprimeve apo praktikave aktuale të planifikuara të dëmshme apo të dyshimta.

Cili është synimi?

- ✓ Për të nxitur drejtësi dhe ndryshim social. Çdokush duhet trajtuar në mënyrë të drejtë.

Veprimi që kryhet:

- Kur demokracia aktualisht ose potencialisht kërcënohet.
- Kur drejtësia e kërkon atë.

Informacioni është i padobishëm nëse nuk bëni diçka me të dhe duke marrë në konsideratë se ka lloje të vëzhgues/qen roje që **nuk bëjnë asgjë** apo thjesht **paralajmërojnë** ata që **mbrojnë** dhe ata që **dëmtojnë**.

Si mund të përmbushni në tërësi funksionin e mbikëqyrësit?

- Kur po kërkonit të krijoni ose ndryshoni ligje, rregullore dhe të tjera të kësaj natyre.

- Kur diçka e re po fillon dhe keni dyshime për ndikimin e saj.
- Kur besoni se interesi publik është i kërcënuar.
- Kur një individ ose organizatë ka rezultuar e pabesueshme në të kaluarën.
- Kur demokracia kërcënohet.
- Kur e kërkon drejtësia.

2.1. PËR TË QENË NJË MBIKËQYRËS EFEKTIV, DUHET TË KRYENI VAZHDIMISHT KËRKIME.

Nëse do të jesh një vëzhgues i efektshëm, duhet të dish se kur një informacion është i rëndësishëm, dhe çfarë do të thotë.

Ky kërkim duhet të përfshijë të mësuarit të gjithçkaje që mundeni për çështjet dhe subjektet me të cilat shqetësoheni; mbledhjen e informacionit për gjendjen aktuale të punëve, dhe politikat dhe praktikat aktuale të subjekteve; dhe ndërtimin e rrjeteve dhe kultivimin e burimeve të informacionit.

Kërkimi mund të jetë një mjet i fuqishëm për t'ju ndihmuar të ndikoni në formimin dhe modifikimin e politikës në çështjen tuaj apo/dhe për të siguruar se çështja është identifikuar me saktësi dhe pastaj trajtohet me efektshmëri.

Nëse qëllimi i kërkimit tuaj është të përcaktoni se cila duhet të jetë politika e nevojshme, për të tërhequr vëmendjen ndaj një çështjeje, për të nxitur miratimin apo braktisjen e një praktike apo qasjeje specifike, për të demaskuar korrupsionin dhe keqbërjet në qeveri dhe biznes, për të mbrojtur publikun, ajo mund të ketë një ndikim të thellë në jetën e komunitetit.

Në këtë kontekst ka një numër hapash për t'u ndërmarrë dhe përdorur kërkimin për të realizuar ndikimin në politikën e përcaktuar nga Ju, si:

- *Përcaktoni se si po përpiqeni të ndikoni politikën.* Ju mund të jeni duke u përpjekur për të gjetur se cila politikë duhet të mbikëqyret; shtyrja e politikës në një drejtim të caktuar; duke advokuar për fonde dhe mbështetje të tjera për trajtimin e çështjes; ose duke advokuar për ose kundër disa praktikave ose qasjeve mjedisore.
- *Identifikoni audiencën tuaj,* ligjvënësit, publikun e gjerë, etj., dhe çfarë lloj provash do të keni.
- *Përdor provat ekzistuese,* për të të ndihmuar të fillosh dhe për ta bërë punën më të lehtë.
- *Bëj kërkimet e vërteta,* duke ndjekur atë që auditori do të pranojë dhe kuptojë.
- *Analizo rezultatet e tua dhe bindu atyre,* edhe nëse nuk janë ato që prisje.
- *Paraqit rezultatet e tua,* duke përdorur parimet bazë të komunikimit për të arritur auditorin e synuar.
- *Vazhdoni kërkimet,* edhe nëse keni qenë të suksesshëm në ndryshimin e politikës, në mënyrë që të dy të tregoni suksesin e këtij ndryshimi, dhe të jeni të vetëdijshëm për nevojën për më shumë si nevojat e komunitetit ndryshojnë.

Mbikëqyrësi/Vëzhguesi duhet të kuptoj që sukcesi varet nga kontakti i drejtpërdrejtë me njerëz dhe të çon në informacionin më të mirë. Është e rëndësishme të njihesh me drejtuesit e strukturave të caktuara vendore, biznesin, organet e tjera ligj zbatuese, specialistë të fushës, të

cilët mund të kenë të gjithë njohuri të rëndësishme për të ndarë me ju, me njerëzit që janë të prekur nga çështja që po mbikëqyreni, etj.

Informacioni është i padobishëm nëse nuk bën diçka me të.

Pasi të keni informacion të dobishëm, duhet të vendosni se çfarë të bëni me të, bazuar në katër mundësi:

- (i) nuk mund të bëni asgjë;
- (ii) mund të dilni publikisht, përmes mediave dhe/ose takimeve publike apo metodave të tjera;
- (iii) mund ta përdorni informacionin si një levë për të nxjerrë veprime të pafavorshme nga një njësi ekonomike, ose për të inkurajuar veprimin për një çështje;
- (iv) mund të filloni një veprim zyrtar, ankesë, një protestë ose padi.

Nëse mund t'i realizoni të gjitha këto, duhet të jeni në gjendje të ndihmoni në mbrojtjen e komunitetit tuaj (në varësi të fushëveprimit) nga zyrtarët dhe agjencitë e paskrupullta ose të paaftë të qeverisë, biznesi, organizatat, institucionet ose grupet e interesit, si dhe të inkurajoni zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve.

Vëzhguesi, ndër të tjera, duhet të mësoj se si të zbuloj se çfarë mendojnë njerëzit për nismat e ndërmarra nga organizata dhe si të përmirësoj komunikimin për të rritur mbështetjen e publikut. Të zbulosh se çfarë mendojnë njerëzit për një çështje, temë ose organizatë të veçantë është një hap i rëndësishëm për t'i shërbyer më mirë publikut. Kësisoj mbledhja e informacionit mbi opinionet është procesi i gjetjes se ku qëndrojnë njerëzit në një temë të veçantë apo që kanë të bëjnë me çështjen ose iniciativën dhe është një hap në drejtimin e duhur.

3. GAZETARIA INVESTIGATIVE DHE ROLI MBIKËQYRËS I SAJ

Gazetaria mbikëqyrëse është një formë e gazetarisë gjurmuese, ku gazetarët apo botuesit e një publikimi lajmesh, kontrollojnë faktet dhe intervistojnë figura politike dhe publike për të rritur përgjegjshmërinë. Gazetaria mbikëqyrëse zakonisht merr një formë të raportimit rreth aspekteve dhe çështjeve të posaçme, të paqarta.

Janë konsideruar tradicionalisht si instrumente për funksionimin e shëndetshëm të demokracisë, pasi gazetaria dhe procesi demokratik janë shumë të ndërlidhura. Duke përmbushur rolin e vëzhguesit/kujdestarit, gazetarët veprojnë si pozita e katërt, duke zbuluar keqbërjet dhe duke shqyrtuar dhe analizuar punën dhe veprimet e autoriteteve qendrore dhe lokale të çfarëdolloj për të hetuar, raportuar dhe nxjerrjen në pah të të metave dhe mosrealizimit si dhe përgjegjësitë përkatëse.

Gjatë punës së tyre, gazetarët mbikëqyrës mbledhin informacion rreth keqbërjeve të njerëzve në pushtet dhe ia dorëzojnë publiku në mënyrë që publiku të mund të kuptojë se çfarë ndodh në shoqëri dhe të ndalojë keqbërjet. Për të bërë punën e tyre, mbajtja e një distance të caktuar nga njerëzit në pushtet është e nevojshme për të sfiduar veprimet e tyre.

Roli i shtypit për të qenë një "mbikëqyrës" dhe për të mbikëqyrur veprimet e një qeverie ka qenë një nga elementët thelbësorë të një shoqërie demokratike.

Gazetarët e përfshirë në këtë fushë të veçantë të raportimit të lajmeve potretizohen si eksplorues ose gjuetarë të çështjeve të rëndësishme të lajmeve, përvoja e të cilëve lind ndjenjat e besimit të padiskutueshëm. Puna si gazetar investigative zakonisht identifikohet me një mentalitet më ndërhyrës, kritik ose skeptik, krahasuar me mentalitetin ose këndvështrimin e adoptuar nga profesionistët që punojnë në raportime rutinë.

Gazetaria investigative u sjell dobi demokracive, duke i njoftuar qytetarët për keqbërje, korrupsion dhe duke i mbajtur aktorët politikë përgjegjës për veprimet e tyre.

Hulumtimi i fokusuar në funksionin mbikëqyrës të gazetarisë ka zbuluar mbështetje të gjerë nga audienca, lidhur me konceptin e organizatave mediatike si vëzhguese të pushtetarëve në një sfond të vlerësimeve kundërshtuese apo të mospërputhjeve në lidhje me masën në të cilën gazetarët janë aktualisht, duke kryer rolin e tyre si roje/mbikëqyrës.

Perceptimet në lidhje me gazetarinë investigative nuk janë identike, pasi praktika e raportimit investigative përjetohet ndryshe në pjesë dhe probleme të ndryshme, në varësi të karakteristikave të veçanta të mjedisit.

Gazetarët, si vëzhgues dhe hetues, kryejnë detyra të ngjashme, por jo identike, kur përpiqen të zbulojnë dhe përshkruajnë korrupsionin dhe abuzimin me pushtetin. Funkzioni mbikëqyrës i gazetarisë është tashmë i pranishëm.

Gazetaria mbikëqyrëse është përkufizuar si: shqyrtim i pavarur nga shtypi i aktiviteteve të qeverisë, biznesit dhe institucioneve të tjera publike, me qëllim dokumentimin, vënien në pyetje dhe hetimin e atyre aktiviteteve, në mënyrë që t'i sigurojë publikut dhe zyrtarëve informacion në kohë për çështjet me interes publik.

Gazetaria mbikëqyrëse nuk ka nevojë të jetë hulumtuese, pasi përbërësi më i rëndësishëm i saj është hetimi i thelluar, mbledhja, dokumentimi e vlerësimi i fakteve dhe raportimi.

Njëherazi, raportimi investigativ ndryshon nga raportimi i përditshëm i lajmeve për sa i përket temave të mbuluara, teknikave të grumbullimit të informacionit të përdorura dhe shkallës së thellësisë së kërkimit që çon në rezultatin përfundimtar. Raportimi investigativ përfshin çështje me rëndësi publike në lidhje me keqbërësit dhe keqbërjet që prekin komunitetet, duke denoncuar tema apo problematika që autoritetet qendrore a lokale kërkojnë t'i mbajnë të fshehta dhe të mos bëhen të njohura për publikun.

Zbulimi i shkeljeve, përkatësisht keqbërjeve ose parregullsive, që përndryshe do të mbeteshin të panjohura është një praktikë kyçe e gazetarëve investigative.

Përmbushja e roli mbikëqyrës presupozon përcjelljen e informacionit për komunitetet që do t'u mundësojë atyre të bëhen aktiv, veçanërisht në ato në zhvillime për të kapërcyer hendekun midis komuniteteve dhe pushtetarëve. Kjo reflektohet në të ashtuquajturin rolin e tyre të përgjegjshmërisë sociale që përfshin mbajtjen e duhur të zyrtarëve publikë në llogaridhënie përmes mbulimit në kohë të lajmeve përkatëse.

Roli mbikëqyrës i gazetarëve, në Shqipëri, megjithëse i ri, ndikohet nga një sërë vështirësish të zakonshme që hasen në rolin mbikëqyrës të tyre, kur ajo praktikohet në mjedise të dobëta politike, ekonomike dhe biznesi. Pengesat kryesore për zbatimin e plotë të funksionit të medias mbikëqyrëse janë mungesa e burimeve financiare dhe mos trajnimi i personelit.

Gjithashtu, janë të ndikuara nga nivele të ulëta të autonomisë dhe profesionalizimit gazetaresk brenda redaksive, si dhe nga mekanizmat e brendshëm të prodhimit të lajmeve nën ndikimin e presioneve, që rrjedhin nga interesat e politikës, qeverisë dhe të biznesit për menaxhimin e lajmeve. Raste këto në shembujt për hetimin dhe denoncimin e ndërtimit të HEC-ve, infrastrukturës, investimeve strategjike në dëm të zonave të ndjeshme dhe të mbrojtura të vendit apo dhe të keqpërdorimit a keqmenaxhimit të burimeve natyrore, të shoqëruara edhe me presione apo dhe keqtrajtim të gazetarit.

Roli mbikëqyrës mbështetet në shqyrtimin e pavarur nga pushtetarët, në mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit për qytetarët që synojnë vendimmarrjen e informuar dhe dhënien e zërit të tyre. Në këtë kontekst, funksioni mbikëqyrës i gazetarisë mund të vazhdojë të kryhet përmes një modeli inovativ dhe të modifikuar të gazetarisë investigative të përshtatur me epokën dixhitale.

Duke vepruar si roje të vërtetë, në vend të lapseve të pushtetit, gazetarët nuk duhet të kënaqen me ndarjen e një vlerësimi të përgjithshëm të gazetarisë investigative, por duhet të përpiqen ta zbatojnë këtë lloj gazetarie cilësore në praktikë, me synimin për t'i shërbyer interesit të komunitetit, për të rritur përgjegjshmërinë politike, për të informuar qytetarët dhe për të inkurajuar dialogun publik, nëpërmjet dhënies së informacionit të duhur dhe të vërtetë.

Gazetarët duhet të jenë të lirë të kryejnë praktikat e tyre të raportimit, bazuar në të drejtën efektive për të aksesuar informacionin publik, të siguruar me ligj. Një cilësi tjetër e domosdoshme është e drejta për të mbajtur sekret burimet, duke ruajtur besueshmërinë e një gazetari kundrejt burimeve të tyre.

Në këtë kontekst nuk mjafton që gazetaria investigative të njihet si e rëndësishme vetëm nga gazetarët, por nevojitet një kulturë e komunitetit, e lirë nga rutinat burokratike apo çdo kufizim tjetër që mund të ndikojë në funksionimin në tërësi të medias mbikëqyrëse.

3.1. NGJASHMËRITË DHE DALLIMET MES NJË MBIKËQYRËSI DHE NJË GAZETARI INVESTIGATIV

Çdokush mund të jetë mbikëqyrës/rojtari, por askush nuk mund të jetë gazetar. Si hetues, gazetarët funksionojnë edhe si kujdestarë. Mund të bëhen lidhje midis punës së qenve mbikëqyrës dhe gazetarisë. Për shembull, të dy gjejnë shprehje në një stil raportimi objektiv, faktik dhe kritik dhe raportojnë jo vetëm atë që thuhet nga njerëzit në pushtet, por edhe janë në gjendje të vënë në dyshim nëse ajo që thuhet është e bazuar në fakte apo ekzagjerime.

Lidhjet mund të tërhiqen edhe me gazetarinë qytetare, ku qytetarët tregojnë përfshirje aktive në procesin e mbledhjes, raportimit, analizimit dhe shpërndarjes së lajmeve dhe informacionit.

Dallimet kryesore konsistojnë në:

1. Gazetarët punojnë kryesisht për të publikuar raportet e tyre, nëpërmjet platformave publike të shtypit ose transmetimit si radio, televizion apo internet. Rojet/mbikëqyrësit nuk synojnë domosdoshmërisht ta bëjnë këtë dhe në vend të kësaj mund të kërkojnë zgjidhje nga vendimmarrësit përkatës.

2. Gazetarët, ndryshe nga rojet/mbikëqyrësit, pranohen gjerësisht nga publiku si sytë dhe veshët e publikut.

3. Ndërsa si mbikëqyrës ashtu edhe gazetarët mund të kenë fusha të veçanta hetimi si biznesi, mjedisi apo shëndeti, shumica e vëzhguesve zakonisht i përmbahen një numri të vogël shkaqesh për t'u mbledhur, duke synuar të shkaktojnë një reagim ose të shohin ndryshime.

4. Gazetarët, janë në gjendje të kritikojnë politikat kryesore shtetërore dhe individët edhe kur një kritikë e tillë është e pahijshme ose e pamundur.

5. Ekziston edhe trajnimi formal për gazetarët, i cili nuk është i disponueshëm për rojet/ mbikëqyrësit.

4. ÇFARË ËSHTË TRANSPARENCA?

Transparenca: nënkupton transparencë, komunikim dhe llogaridhënie. Gjithashtu, nënkupton që ndarja e informacionit të plotë, të saktë, në kohë dhe të dobishme rrit njohuritë, ul rrezikun dhe rrit vendimmarrjen, zgjedhjen ose veprimin nga përdoruesit e informacionit dhe zbuluesit, veçanërisht për çështjet që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien publike.

Transparenca: është besim i ndërsjellë, ndërtohet aty ku pala përgjegjëse ofron informacionin e duhur për publikut, duke lejuar akses të lehtë në informacionin e saktë kur është e nevojshme.

Karakteristikat kryesore të transparencës:

- Qartësia se si formohen strukturat në nivele të ndryshme lokale.
- Qartësia në vendim dhe në proceset e zhvilluara.
- Objektiva të qarta që e bëjnë të lehtë monitorimin, vlerësimin, gjurmimin, performancën dhe rezultatet programore.
- Ndarje informacioni, duke përfshirë të dhënat.
- Hapja ndaj ideve dhe reagimeve, veçanërisht nga nivelet lokale.

Transparenca mund të kategorizohet gjerësisht në tre mënyra: **E errët**; **E qartë** dhe **E synuar**.

Transparencë e errët, i referohet shpërndarjes së kufizuar të informacionit, zakonisht duke mos zbuluar specifikat, p.sh, se si institucionet në të vërtetë sillen në praktikë, si marrin vendime ose rezultatet e sakta të veprimeve të tyre. Një transparencë e tillë zakonisht ofron informacion të përmbledhur dhe të paplotë dhe mund të rezultojnë të pabesueshme.

Transparencë e qartë, i referohet shkëmbimit të informacionit të qartë, gjithëpërfshirës dhe të besueshëm mbi politikat dhe programet ose performancën, përgjegjësitë dhe shpenzimet institucionale. Një transparencë e tillë mund të quhet edhe si e plotë ose transparencë e gjerë.

Transparenca e synuar, përkufizohet si politika të ligjëruara nga qeveria për të përmirësuar veprimtarinë dhe cilësinë e shërbimit publik, për të reduktuar rreziqet, sigurinë dhe stabilitetin financiar ose për të përmirësuar performancën e institucioneve kryesore. Kjo përdoret veçanërisht kur transparenca e qartë ose e gjerë mund të ketë ndikime negative, kryesisht në situata ku nevojiten zgjedhje të caktuara nga publiku.

Transparenca bazohet kryesisht në shkallë të ndryshme të hapjes, e cila herë pas here mund t'i shërbejë nevojave publike dhe herë jo. Gjithashtu, politikat e transparencës shpesh kufizohen nga dinamika politike dhe bazohen në kompromise që vijnë nga probleme që kërkojnë zgjidhje. Në shumicën e rasteve, zgjidhje të tilla rrjedhin nga interesa të ndryshme dhe vlera kontradiktore se sa informacione duhet të bëhen publike dhe në çfarë formati. Shumë sisteme

që kërkojnë të jenë më transparente shpesh përdorin stimuj që evoluojnë sipas këtyre interesave dhe presioneve të ndryshueshme (zakonisht politike, ekonomike ose mjedisore).

4.1. TRANSPARENCA SI E DREJTË PËR INFORMACION PUBLIK: A ËSHTË E DREJTË TË DISH APO TË KUPTOSH?

Një mbikëqyrës vë në dyshim nëse masat e transparencës ekzistuese në një vend inkurajojnë vërtet zbulimin dhe nëse një zbulim i tillë çon vërtet në shpërndarjen e informacionit të dobishëm. Për të përcaktuar se në çfarë shkalle ndodh zbulimi, një mbikëqyrës duhet të ndërtojë një kuptim të kornizave ligjore të nevojshme që ndikojnë në fushën e tyre të punës. Ata e bëjnë këtë duke mësuar kornizat që ekzistojnë dhe duke vlerësuar nëse këto ofrojnë të drejtën për të njohur qëndrimin e publikut ose të zyrave të autoritetit dhe nëse ato ofrojnë informacion të dobishëm, real dhe të prekshëm që plotëson nevojën për njohuri dhe mirëkuptim nga palët e interesuara.

Gjithashtu duhet të ofrojnë strategji për mënyrën e trajtimit të moszbulimit në mjedise që ofrojnë pika hyrëse të paqarta nëpërmjet kornizave ekzistuese ligjore ose politike.

Për të nxitur për një transparencë më të mirë, së pari duhet të dihet se çfarë dëshiron të arrijë në përpjekjet e tyre për transparencë. Më tej, është një njohje e pengesave të pritshme, siç janë çështjet politike apo lojërat e tjera të pushtetit.

Më pas, një roje mund të zgjedhë të testojë idetë e tij fillestare përpara se të ndërmarrë veprime. Ata mund t'a bëjnë këtë nëpërmjet diskutimeve, përmbledhjeve/dokumenteve, seminareve dhe artikujve që më pas do t'i ndihmojnë të identifikojnë ose hartojnë karakteristikat e përbashkëta, rrënjët dhe sfidat e çështjeve të transparencës që kërkojnë të trajtojnë dhe dinamikën e tyre mbizotëruese.

Është mirë ta bësh këtë herë pas here për të qartësuar objektivat e dikujt, për të matur rezultatet e prekshme ose për të vërtetuar procesin ose punën e bërë. Vetëm atëherë një mbikëqyrës mund të zbatojë një veprim që ose kërkon zgjidhje ose ndikon në ndryshim brenda politikave ose audiencave të synuara.

5. ÇFARË ËSHTË LLOGARIDHËNIA?

Llogaridhënia është e mbushur me kuptime, standarde dhe kritere të ndryshme, të gjitha të bazuara në atë se kush e përdor termin dhe ku qëndron vendi i përgjegjësisë. Megjithatë nënkupton një ndjenjë përgjegjësie për efektet e veprimeve të dikujt dhe një gatishmëri për të shpjeguar ose për t'u kritikuar për to.

Termi bazohet gjithashtu në interpretime dhe kuptime të ndryshme se kush duhet të mbahet përgjegjës, nga kush, si dhe për çfarë. Kjo mund të bëhet shumë konceptuale dhe e vështirë për t'u imponuar ndonjëherë.

Karakteristikat kryesore të përgjegjësia:

- Qartësia se kush është përgjegjës, për çfarë.
- Përgjegjshmëri ndaj shqyrtimit ose hetimit.

- Aftësia dhe gatishmëria për të qenë i përgjegjshëm; për t'u mbajtur llogari për çështjet përkatëse.
- Komunikim i qartë rreth pyetjeve të ngritura, duke dhënë përgjigje që plotësojnë nevojat e komuniteteve apo përfituesve të synuar.

Përgjegjësia përfshin: **përgjegjësinë** e bartësve të detyrës për të ofruar informacion dhe arsyetim për veprimet e tyre, veçanërisht kur rezultatet nuk arrihen siç priten) dhe **zbatueshmëria** mundësinë e dënimeve ose pasojave për mospërgjegjjen e pretendimeve të llogaridhënies).

5.1. LIDHJA MES TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES

Transparenca fokusohet në cilësinë e informacionit. Kjo cilësi matet zakonisht bazuar në atë se sa të hapura janë burimet e informacionit, nëse informacioni i dhënë është në formatin e kërkuar dhe cili është ndikimi i gjeneruar nga ai informacion. Llogaridhënia fokusohet në proceset dhe aktorët përgjegjës që çojnë në ofrimin e informacionit cilësor dhe kanalet për reagime dhe përgjegjësi.

Që njeriu të jetë i përgjegjshëm, së pari duhet të jetë transparent.

Nevoja për transparencë dhe llogaridhënie bazohet në supozimin se qasja në informacione (publike) është e drejtë themelore e qytetarit. Në shoqëritë demokratike, kjo nënkupton edhe lirinë e qytetarëve për të pyetur, hetuar, raportuar, publikuar, kritikuar dhe zbuluar informacionin e mbajtur publikisht. Ka pasoja për një hapje të tillë, edhe në shoqëritë demokratike. Ai rrit njohuritë e qytetarëve për çështje të ndryshme duke i hapur ata ndaj dialogut dhe diskutimeve më të thelluara dhe më të thella që mund të përmirësojnë politikat dhe vendimet e marra nga shteti ose të ngrenë pyetje të pakëndshme.

Gjithashtu, disa nivele të transparencës mund të shkaktojnë rrjedhje në sigurinë kombëtare ose të ngatërrojnë përgjigjet kombëtare të cilat mund të jenë të dëmshme. Në të gjithë e ndodhur përfitimet e llogaridhënies dhe transparencës janë të qarta, duke përfshirë përmirësimin e performancës, pjesëmarrjes dhe përfshirjes, rritjen e ndjenjave të kompetencës dhe angazhimit nga ata që janë përfshirë, më shumë kreativitet dhe inovacion, si dhe moral dhe kënaqësi më të lartë me punën e bërë.

Megjithatë, transparenca dhe llogaridhënia mund të shihen gjithashtu si eufemizma për "ndëshkim" ku ata që nuk kryejnë duhet të përballen me "pasojat".

Perceptime të tilla mund të kenë pasoja të paqëllimshme dhe të nxisin shkëmbime ndërmjet llogaridhënies/transparencës nga njëra anë dhe performancës nga ana tjetër.

6. PESË QASJE STRATEGJIKE PËR MBIKËQYRËSIT LOKALË

HAPI I PARË: ÇAKTONI TEMATIKËN/ÇËSHTJEN QË DONI TË MBIKËQYRNI.

E rëndësishme është që në këtë proces të jini mjaft të qartë se përse po mbikëqyrni këtë çështje/problematike, duke marrë në konsideratë:

1. Qëllimi i përgjithshëm:

- “Çfarë doni të arrini në planin afatgjatë”?
- “Çfarë doni të kërkon nga organet përgjegjëse shtetërore, në nivel lokal?”
- “Çfarë doni të ndryshoni dhe nga cili/ët e presin këtë ndryshim”?
- “Çfarë doni të ndryshoni në sjelljen dhe vetëpërgjegjëshmërinë e komunitetit dhe të palëve të tjera të interesit”?

2. Objektivat specifike:

Cilët janë hapat e matshëm që duhet të përmbushni për të ecur drejt qëllimit tuaj?

Përcaktimi i asaj që doni të arrini është vendimtar. Kur keni një qëllim të përcaktuar mirë, mund të mbështeteni plotësisht në të dhe ju ndihmon të udhëheqin pengesat dhe të përcaktoni edhe gjëra të tjera: Kë duhet të bindni dhe çfarë veprimi specifik duhet të ndërmerri; çfarë dëshironi të adresoni, përmes strategjisë dhe të mjeteve që duhet të përdorini.

Në përpjekjet ose fushatën që do të ndërmerri duhet të përcaktoni një ndryshim specifik në politikën që do të dëshironi të arrini. Është e domosdoshme që të përcaktoni dhe veprimin më specifik me të cilin do të përqendroheni mbi vendimmarrësit, palët e interesuara ose ndikuesit, duke u fokusuar:

Cila është çështja/et që lidhen me tërësinë e problematikave që shqetësojnë komunitetin në nivelin lokal, që lidhen me përmirësimin e menaxhimit, ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të mjedisit apo/dhe burimeve natyrore?

Pasi të keni përcaktuar se tek cilët prej grupeve përbërëse të komunitetit do të fokusoheni, çdo pjesëtar i grupit të OJF-ve duhet të përfshihet në procesin e reagimit ndaj çështjes/ve që shqetësojnë komunitetin.

Pas identifikimit të çështjes/ve që janë me interes për komunitetin, pjesëtarët e grupit të OJF-ve duhet të:

- Zhvillojnë biseda informale me individë që i përkasin grupit/eve të shënjestruara.
- Përdorimin e burimeve, mjetet teknike dhe profesionale të ndryshme që kanë ndikim të drejtpërdrejt mbi komunitetin në tërësi.

HAPI I DYTË: ANALIZONI TEMATIKËN.

Analiza e tematikës është hapi më i rëndësishëm i të gjithë procesit mbikëqyrës. Në këtë çast mësoni gjithçka që nevojitet, në mënyrë që të shpjegoni apo diskutoni në tryeza të ndryshme, në lidhje me çështjen dhe situatën për të cilën jeni të interesuar.

Në fillim duhet të merrni vendimin se çfarë çështje (brenda fushëveprimit tuaj të punës) do të merreni me të dhe çfarë doni të arrini. Ju duhet të pyesni se çfarë (pikërisht) e konsideroni si

problem dhe i kujt është problemi më i rëndësishëm. Gjithashtu, duhet të dini se si është gjendja aktuale, cilat janë politikat, ligjet dhe rregulloret përkatëse që e formësojnë këtë gjendje aktuale.

Në përputhje me grupin e shënjestruar dhe çështjet e identifikuar duhet të fokusoheni tek problematikat e ruajtjes, promovimit dhe adresimit të një menaxhimi të qëndrueshëm të mjedisit, vlerave dhe burimeve natyrore, apo për ZMM, të lidhura me organet përgjegjëse shtetërore, por edhe me organet e pushtetit vendor, që kanë detyrime për të përmbushur të gjitha nevojat apo pritshmëritë e komunitetit për burime natyrore.

Andaj është e domosdoshme që të identifikoni se “kush” është përgjegjës dhe për “çfarë” në nivelin lokal, në lidhje me politikat, administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e burimeve natyrore, brenda territorit të bashkisë.

Rrugët mund të jenë nga më të ndryshmet në funksion të objektivit dhe organeve që shënjestroni (targetoni). Me qëllim që të komunikoni në mënyrë efektive, duhet identifikuar qartë publiku kryesor apo grupet e synuara, duke përfshirë figura që kanë ndikim (ato jo qeveritare) dhe mediat, të cilat kanë një interes në veprim ose janë të prekura.

Pjesëmarrja e qytetarëve nuk duhet kërkuar në situata të veçanta, por duhet të jetë pjesë e jetës së përditshme.

Për të realizuar këtë hap dhe të gjeni zgjidhjet e dëshiruara, duke u fokusuar qartë tek objektivat, ç’ka bën më efektive mbikëqyrjen, tek përpjekjet për të ndikuar çështjen, nëpërmjet aktiviteteve të mirë caktuara dhe arritjen e efektivitetit me rezultatet të matshme.

Problemi kryesor, jo domosdoshmërisht, përfaqëson çështjen që do ndiqini gjatë mbikëqyrjes, e cila duhet të jetë e përmasave që organizata partnere dhe rrjetëzimi lokal të mund t’u përballojnë dhe të përputhje me misionin dhe parimet e punës së OShC-së.

Analiza e aktorëve të interesit është një element i rëndësishëm në procesin e mbikëqyrjes, i cili mund të kryhet në çdo moment pasi të keni zhvilluar analizën e gjendjes edhe lidhjen me çështjen e advokimit.

Palët e interesit janë individë ose grupe, interesat e të cilëve preken ose mund të preken nga procesi/aksioni, dhe në këtë mënyrë mund të ndikojnë në këtë çështje. Analiza e aktorëve të interesit është procesi i identifikimit të këtyre individëve apo grupeve.

Në një analizë të mirëfilltë të palëve të interesit nuk mund të mjaftoheni vetëm me listimin e tyre, por zakonisht realizohet edhe një kategorizim të tyre. Ka disa mënyra se si mund të realizohet dhe disa kritere që mund të përzgjedhin në mënyrë praktike dhe të thjeshtuar për t’u vënë në zbatim, si më poshtë:

1. Analizoni grupet që kanë interesa direkte dhe jo direkte me çështjen.

Është e rëndësishme që në të kategorizoni grupet me interesa të drejtpërdrejtë me çështjen, të cilët mund të ndikohen ose jo, por jo në plan të parë. Kjo ndihmon të orientoheni se ku të fokusoni më shumë veprimin tuaj.

2. Përcaktoni qëndrimin e tyre ndaj çështjes.

Qëndrimi i aktorëve ndaj çështjes mund të jetë: a) mbështetës b) asnjënjës dhe c) kundërshtarë.

Duke bërë këtë kategorizim ju përcaktoni më mirë strategjinë e përfaqësues ndaj secilit aktor dhe ajo ç'ka zakonisht synoni është që kundërshtarët e çështjes t'i bëjnë neutral dhe ti nxisni që t'iu përkrahur.

Në analizën e aktorëve të interesit duhet të përfshini edhe aktorët/personat të cilët kanë influencë dhe mbështetjen e një publiku më të gjerë dhe që rrisin shkallën e ndikimit.

3. E bëni çështjen publike.

Mund të këtë shumë kuptime, por në rastin konkretë nënkupton advokimin në media dhe nisjen e një fushate të fuqishme, në mënyrë që të arrini një publik sa më të gjerë. Kjo fazë kërkon një punë të mirëfilltë përgatitore, por shumë të shpejtë, pasi përpara se të dalin në publik duhet të keni një mesazh shumë të qartë dhe objektiva të mirë përcaktuara.

4. Ndërmerrni një veprim zyrtar.

Në këtë kontekst duhet të njihni mirë edhe disa nga mjetet që mund të përdorni në aktivitetin e mbikëqyrjes, duke përfshirë këta elementë:

- Deklarata dhe Konferenca për shtyp.
- Debate, qëndrime publike për çështje të interesit publik.
- Organizim të paneleve, seminareve, pjesëmarrje dhe komunikim nëpërmjet mediave.
- Organizimi i tryezave të përbashkëta të rrumbullakëta, i mbledhjeve të hapura, shkëmbimit të informacionit dhe të përvojave.
- Komunikim të drejtpërdrejt me publikun, ligjvënësit, ligj zbatuesit dhe palët e interesuara.
- Intervistat me personat përgjegjës.
- Takime formale dhe informale me nivele të larta të menaxhimit.
- Marrja pjesë në takimet për të dhënë mendime.
- Kërkesë për informacion apo shpjegime për ankesa të qytetarëve.
- Paraqitja e rekomandimeve dhe sugjerimeve për përmirësimin e aspekteve të ndryshme të administrimit dhe menaxhimit të ZMM dhe të burimeve natyrore.
- Publikimi i raporteve vlerësuese, monitorues dhe investigues.
- Fletëpalosje, broshura, postera, buletine, artikuj promovuese, Ditarin e Natyrës, fotografitë, etiketa, logo.
- Faqet internet (web) dhe përdorimin i rrjeteve sociale.
- Tabela informuese, baner, materialet dhe pajisjet të tjera ndihmëse.
- Prodhime audiovizuale dhe video.
- Organizimi i fushatave informuese, koncerte, aktivitete sportive, shfaqje filma mjedisore, ngjarjet publike, vizita, ditët mjedisore, panairë dhe pllakata mirënjohjeje.

HAPI I TRETË: KËRKIMI I TË DHËNAVE.

Mekanizmat e kërkimit dhe mbledhjes së të dhënave janë të shumta, megjithatë organizatat apo personat që punojnë për mbikëqyrjen mjedisore, duhet të marrin në konsideratë disa teknika për kërkimin dhe hetimin e tyre.

Kërkimet mund të të ndihmojnë të arrish në synimin e planifikuar, duke:

- a. Mësuar gjithçka që duhet të dini për të qenë në gjendje të shpjegoni dhe diskutoni sfondin e çështjes/ve, situatave dhe subjekteve me të cilat jeni të shqetësuar.
- b. Mbledhur fakte rreth gjendjes aktuale të çështjes dhe/ose në lidhje me politikën dhe praktikën aktuale të subjekteve me të cilat jeni të shqetësuar.
- c. Ndërtoni një rrjet dhe siguroni burimet.

Po ashtu:

- Kërkimet të japin lëndën e nevojshme të këshillimit, pasi kërkimet bazohen dhe shtojnë fakte dhe statistika besimit çështjes së mbikëqyrjes;
- Kërkimet të japin informacione të reja që të ndihmojnë për ta bërë çështjen shumë bindëse dhe për të parë rezultatet e pritshme, nga mosbërja asgjëje;
- Kërkimet mund t'ju tregojnë se çfarë duhet më shumë që të trajtoni çështjen me sukses, shërben për qëllime të shumëllojshme, ju ndihmon që të zgjidhni dhe të përkrahni strategjinë që janë të përshtatshme për të qenë të efektshme;
- Kërkimet mund t'ju japin shembuj për t'i përdorur në situata të caktuara dhe e bën çështjen të menjëhershme dhe reale. P.sh. Kërcënimet mjedisore apo ndaj mirëqenies publike nuk janë i vetmi lloj dëmi që kërkimet mund të ndihmojnë për të parandaluar. Duke parë efektet e politikave të propozuara qeveritare mund t'i shpëtojnë qytetarët nga pasojat sociale, ekonomike, mjedisore ose do të ndihmojë për të korrigjuar këto pasojat;
- Kërkimet mund të vërtetojnë të "dini" se keni të drejtë për çështjen e caktuar, dhe kjo sjell shumë më tepër siguri për të treguar se jeni duke mbrojtur këtë çështje vërtetë të mirë për komunitetin;
- Kërkimet të japin besueshmëri. Nëse i bën mirë kërkimet do të ndihmojnë në përpjekjet tuaja për t'i bindur njerëzit si dhe do t'i bëjë ata më të gatshëm të të dëgjojnë dhe të besojnë. Gjithashtu, mund të shërbejnë për të gjetur prova që demaskojnë zyrtarët e korruptuar, të pandershëm ose joetikë;
- Kërkimet mund ta shkurtojnë kundërshtimin. Nëse keni bërë kërkime të kujdesshme, jo vetëm për qëndrimin tuaj, por edhe për kundërshtitë, do të keni informacionin e duhur për t'iu përgjigjur akuzave apo/dhe pyetjeve, për të hedhur poshtë pretendimet, për pasur të argumente të arsyeshme dhe të bazuara ndaj kundërshtimeve;
- Kërkimet duan shkencëtar dhe ekspert për çështjen, të cilët njohin mirë problematikën, që shtjellojnë argumentet dhe japin përgjigjet e duhura, për shqetësimet a interesat e tjera të grupeve të interesuara, komunitetit, përfshi edhe autoritet publike, biznesin dhe individët, bazuar në studime dhe rezultate shkencore. Një studim është një hetim, i bazuar në parimet e shkencave natyrore apo ekonomiko-sociale, të një dukurie apo çështjeje që lidhet me mjedisin dhe komunitetin.

Përpos këtyre, kërkoni ndihmë. S'ke pse i bën të gjitha vetë!

Nëse jeni të shqetësuar për një çështje, mundet që një pjesë të mirë për informacionin që ju nevojitet mund ta siguroni nga veprimtarët e tjerë, pra një informacion të parapërgatitur prej tyre.

- ✓ **Përdor intervistat dhe bisedat**

Kur informacioni që po kërkonti ka të bëjë me individë apo/dhe komunitet me marrëdhëniet midis tyre dhe qeverisjes vendore apo biznesin, mund te përdorini takimet, intervistat dhe bisedat me ta.

✓ **Përdor sondazhet/pyetësorët**

Nëse doni të dini se çfarë mendojnë shumica e njerëzve në komunitet për çështjen që mbikëqyrni përdorni sondazhet apo pyetësorët (zakonisht përbëhet nga një listë e pyetjeve të thjeshta mbi çështjen) është një mjet a mënyrë (e larmishme) për të siguruar një informacion të shpejt. Po kështu është një mundësi për të anketuarit për të shprehur një mendimet ose koment e tyre mbi problematikën.

✓ **Shfrytëzo bibliotekat**

Janë burim i madh informacioni dhe nga më të besueshëm.

✓ **Përdor internetin dhe portalet**

Janë një burim i madh dhe i larmishëm informacioni, por nuk ka garanci se ndonjë prej tyre është i saktë dhe kërkohet që informacioni i përcjellë prej tyre, para përdorimit të verifikohet dhe të krahasohet edhe me tre burime të tjera.

✓ **Shfrytëzo gazetarët**

Veçanërisht gazetarët investigative, me të cilët bashkëpunimi mund të jetë i domosdoshëm në kuadër të sigurimit të informacionit të duhur për problemin që mbikëqyrni.

Ku mund të gjeni informacione nga burime të tjera?

Burimet që do të përdoren për identifikimin, vlerësimin e problematikave dhe të reagimit ndaj tyre duhet të jenë të pa kufizuara, të integruara dhe një kombinim mes tyre. Një nga format më të zakonshme të komunikimit zyrtar, në kërkimin e informacionit, janë edhe letër kërkesat për informacionin e dëshiruar.



Burimi i informacionit është administrata publike qendrore dhe vendore.

Marrja e të dhënave zyrtare nga takimet e drejtpërdrejtë, përmes kërkesë apo dhe të faqeve të internetit të institucioneve publike.

Analizën ligjore-institucionale dhe shqyrtim të dokumentacionit, vlerësoni si metodë cilësore e cila përfshin një analizë të të gjitha akteve ligjore në fuqi, vendime të Këshillit të Ministrave (VKM) në lidhje me administrimin dhe qeverisjen e burimeve natyrore; kuadrin ligjor që rregullon fushën e veprimit të institucioneve përgjegjëse në nivel lokal; të aktet administrative që përcaktojnë rregulla të përgjithshme, programe, plane zhvillimore, të menaxhimit dhe të veprimit në mjedis, projektet për burimet natyrore dhe zonat e mbrojtura, raportet, analizat dhe çdo informacion përkatëse në lidhje me problematika mjedisore dhe të burimeve natyrore, norma e standarde të detyrueshme në kushtet e qeverisjes vendore.

Këto burime duhet të përdoren në procesin e vlerësimit në mënyrë që të përftohet një panoramë e përgjithshme e qeverisjes së burimeve natyrore si dhe e identifikimit të shkaqeve më të ekspozuara ndaj riskut të ndikimeve negative në mjedis.

Mos u tërhiqni nga nisma juaj në rastin se hasni pengesa në komunikimin me institucionet qeveritare (shpesh herë edhe kundërshti dhe kërcënim prej tyre). Punonjësit e administratës shtetërore ende nuk i njohin apo nuk i marrin seriozisht detyrimet e tyre për t'iu përgjigjur publikut, të cilë kanë të drejtë ligjore për të marrë informacion; punonjësit e administratës publike kanë detyrimin për të dhënë informacion, dhe e drejta e publikut për t'iu drejtuar gjykatës.



Burimi i informacionit nga bizneset dhe përdoruesit e burimeve natyrore.

Kërkimi i informacionit nga bizneset, përdoruesit dhe përfituesit e burimeve natyrore, që punojnë në nivel vendor, shpesh është më i vështirë dhe burokratik. Arsyeja mbetet se shumica e tyre nuk i disponojnë dhe kur i kanë nuk t'i vënë në dispozicion, nuk gjenden të dhëna online dhe nuk ekziston informacion i hapur në lidhje me to. Kështu çdo informacion merret nga vëzhgimet në terren si dhe duke dërguar kërkesa zyrtare për informacion, në institucionet publike përkatëse në nivel vendor dhe qendror.



Burimi i informacionit nga proceset gjyqësore.

Një burim i besuar informacioni janë dhe të dhënat që sigurohen nga proceset e organeve të hetimit dhe të gjyqësorit, të cilat mund të merren përmes letrave zyrtare ose nga publikimet e bëra prej tyre.

Ndërkohë, bazuar në vëzhgime dhe argumentime, për një problem specifik, me ndikim të veçantë në mjedis dhe përdorime joligjore e jobiologjike të burimeve natyrore apo/dhe të rasteve kur cenohet komuniteti, duhet t'i drejtoheni organeve publike përgjegjëse dhe vendimmarrësve për të marrë informacionin e duhur. Por, në rastet kur nga ata nuk është marr asnjë përgjigje apo zgjidhje, duhet bërë edhe ankesa për këtë çështje në organet përkatëse të hetimit dhe gjyqësorit.

HAPI I KATËRT: VENDONI SE ÇFARË DO TË BËNI ME INFORMACIONIN E GRUMBULLUAR.

Informacioni që keni grumbulluar përbën “thesarin” e çështjes së mbikëqyrjes. Nuk është e rëndësishme nëse keni gjetur pikërisht atë që kërkoni ose jo; nëse informacioni që keni siguruar devijon nga mendimi apo hamendësimi fillestar; nëse ide të reja apo një plan i ri duhet menduar sepse nuk keni mjaftueshëm informacion; nëse aktorët apo grupet e synuar nuk janë përgjigjur apo shumë prej palëve të interesit janë kundërshtarë të çështjes etj., në këtë moment duhet të vendosni se çfarë do të bëni me të dhënat që keni.

Si të shfrytëzoni informacionin në të mirë të çështjes që po mbikëqyrni?



Duke mos bërë asgjë.

Gjatë kohës që jeni në kërkim të informacionit mbi çështjen mjedisore, situata mund të këtë filluar të ndryshojë në drejtimin e duhur dhe midis palëve të prekura ka nisur një proces negociimi. Kjo përfaqëson shumë pozitive dhe një vëzhgim i mirë mjedisore duhet gjithmonë që në çdo hap të saj të synojë nxitjen e bisedimeve dhe bashkëpunimeve, pra negociatave. Në këtë rast nuk është e nevojshme të ndërmerren veprime të tjera.

Duke bërë çështjen publike.

Mund të këtë shumë kuptime, por në këtë rast nënkupton advokimin në strukturat publike, private e media, bërjen publike të problemit si dhe nisjen e një fushate të fuqishme advokim/lobimi, në mënyrë që të sigurojmë një mbështetje publike sa më të gjerë.

Në këtë kontekst OSHC-të dhe rrjetet lokale ndihmojnë në forcimin e bashkëveprimit dhe përmirësimin e bazës së njohurive dhe në këtë mënyrë rritet edhe ndikimi i shoqërisë civile në komunitet, për një ose disa çështje me interes madhor të tyre.

Qasja e lehtësimit bashkëpunues, për zgjidhje alternative të konflikteve, mund të realizohet nëpërmjet OSHC-ve, të cilat, me mbështetje teknike dhe logjistike, e përcjellin më mirë se kushdo në publik shqetësimin dhe organizimin e reagimit, ndaj strukturave përgjegjëse. Takimet duhet të jenë korrekte, duke trajtuar një çështje konkrete që nxitë sedrën dhe angazhimin konkret të tyre.

Roli i ndërmjetës dhe lehtësues duhet të jetë neutral dhe i pavarur, pasi është një rol teknik në organizimin e procesit të identifikimit, organizimit, komunikimit, lobimit dhe reagimit ndaj dukurive negative apo proceseve që cenojnë jetesën e komuniteteve, por njëherazi edhe ekzistencën e vlerave dhe të burimeve natyrore.

Funksionimi i rrjeteve, në të tri bashkitë, në kuadër të projektit, nuk shërben vetëm për të arritur një konsensus mbi çështje të caktuara, por më i rëndësishëm është krijimi i një platforme për shkëmbimin e ideve dhe njohurive në lidhje me objektiva të përbashkëta.

Në këtë sens është i dukshëm roli i OSHC-ve lidhur me paqëndrueshmërinë politike, për presionet në rritje mbi burimet natyrore (të cilat janë jetike për ekonominë lokale), praktikat e papërshtatshme bujqësore, shfrytëzimi dhe papërgjegjësia e palëve të interesuara, konteksti i paqartë dhe i papërshtatshëm institucional dhe ligjor; kompetencat dhe ndarje e përgjegjësisë midis palëve të interesuara, etj., kërkojnë qeverisje të përbashkët të përdorimit të burimeve natyrore dhe menaxhim të përgjegjshëm të tyre.

OSHC-të, sidomos rrjetet lokale, janë një grup i kufizuar në numër që reagojnë për një çështje të rëndësishëm edhe për komunitetin. Që reagimi i tyre të bëhet edhe më i fortë ndaj organet shtetërore përgjegjëse, duhet të mobilizoni komunitetin dhe palët e interesuara, të cilët janë identifikuar paraprakisht dhe e ndjeni si nevojë mbështetjen e tyre për një zgjidhje konsensuale.

Në bërjen publike të çështjeve që mbikëqyren është e nevojshme arritja e një koordinim më i mirë i punës midis OSHC-ve për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe qeverisjen e mirë në nivel lokal, mbështetjen në komunitet për të mundësuar dhe luftën ndaj korrupsionit.

Kjo fazë kërkon një punë të mirëfilltë përgatitore. Përpara se të dalin në publik duhet të keni një mesazh shumë të qartë dhe objektiva të mirë përcaktuara. Për këtë OSHC-të duhet të vazhdojë punën, jo vetëm për të identifikuar raste të moszbatimit të ligjit, të dëmtimit dhe keqpërdorimit të mjedisit dhe të burimeve natyrore, etj., por edhe për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit komunitar për problemet shoqëruese dhe ndikimin e tyre.

Shoqëria civile duhet të përdorë në mënyrë krijuese instrumentet si mediat sociale, etj., për të promovuar integritetin, transparencën, kërkesën e llogarisë dhe qeverisjen e duhur. Disa nga mënyrat se si mund ta realizoni advokimin në mediat janë takimet e hapura, pjesëmarrje në

emisionet televizive me shikueshmëri të lartë, një raport mbikëqyrës i bërë publik dhe deri në organizimin e protestave.

Po ashtu duhet të formulojnë dhe të përçojnë mesazhe më të qarta në lidhje me pjesëmarrjen dhe debatin publik rreth problematikave që shqetësojnë dhe prekin komunitetin, të jenë në kontakt të vazhdueshëm me jetën e përditshme të komuniteteve, për të ndërtuar marrëdhënie sa më optimale në terren. Sjellja e tyre në komunitet duhet të jetë shembullore, duhet të shërbejnë si model pozitivë në bashkësitë e tyre dhe të përpiqeni të krijoni një opinion sa më të mirë në publik, për shoqërinë civile.

➔ **Bërja publike e informacionit për mbikëqyrjen e problemit mjedisor do t'iu ndihmoj:**

- *Për të tërhequr vëmendjen e publikut ndaj çështjes që mbikëqyrret, që do t'i ndihmojë njerëzit të kuptojnë se si lidhet çështja me interesat e komunitetit.*
- *Të demonstrojë mbështetjen publike për çështjen, në një mënyrë të mundshme që tregojnë se komuniteti e mbështet këtë çështje.*
- *Për të udhëhequr përpjekjet për mbrojtjen e mjedisit dhe të burimeve natyrore, duke mbështetur dhe treguar se çfarë komuniteti apo individë të veçantë, mendojnë se kjo çështje i ndihmon ata të vendosin t'i qasen kësaj nisme.*
- *Për të mbështetur argumentin me fakte, opinione të respektuara përfshirë përvojën dhe praktikën më të mira në këtë fushë.*
- *Për t'iu kundërvënë pretendimeve apo kundër-argumenteve të gabuara të kundërshtarëve.*
- *Të demonstrohet se trajtimi i çështjes do të ketë përfitime për komunitetin apo dhe për ata që preken drejtpërdrejtë.*
- *Për të provuar keqbërës, praktikën e diskutueshme, veprimin e gabuar e të dëmshme. ryshfet, shpërdorim të fondeve publike apo korrupsionin nga ana e një zyrtari të qeverisjes vendore, biznesit etj.*

Në kuadër të një procesi konsultimi, për çështjet publike që mbikëqyrjen, me pjesëmarrjen e banorëve, përdoruesve të ndryshëm të burimeve natyrore, OJF-t mjedisore, biznesin, autoritetet lokale dhe grupe të tjera interesi, duhet ndërtuar një vizion dhe zgjidhje të përbashkët për ruajtjen e mjedisit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. Platforma e dialogut duhet të krijojë modelin e qeverisjes dhe zbatimit të rregullave apo/dhe të mirë përdorimit të burimeve dhe të peizazhit natyror.

Mos bëri publik të problematikave dhe të mungesë së angazhimit të palëve të interesuara, ka sjell përdorim të paqëndrueshëm të burimeve natyrore; mos kryerjen e analizave të nevojshme për të identifikuar ndikimet dhe boshllëqet në qasjet ekzistuese të ruajtjes së mjedisit, natyrës, të përbërësve biologjik dhe ekologjik si dhe ZMM me rëndësi ruajtjeje, etj.

Këto mangësi duhet të ndihmojnë OSHC-të partnere dhe rrjetet e tyre lokale për të kuptuar dhe përcaktuar zgjidhjet e duhura, të lidhura me përmirësimin e qeverisjes, zhvillimin e proceseve pjesëmarrëse që lidhen me interesat e banorëve/komuniteteve lokale si dhe për të adresuar tek organet shtetërore qendrore dhe lokale zgjidhjet e nevojshme, mbështetjen teknike, financiare dhe burimet njerëzore për të arritur suksesin e dëshiruar.

Të dhënat e siguruara në nivel komunitetit, nxjerrja në pah e rezultateve pozitive nëpërmjet postimit dhe të bëra publike, si një mjet për të inkurajuar mbështetjen publike, njëherazi mund të përdoren për të promovimin dhe edukimin e anëtarëve të organizatës dhe të komunitetit.

Veç kësaj, rezultatet e dialogut publik të bashkëbisedimeve me palët e interesit dhe grupet kryesore të përdoruesve, gjithashtu, mundësojnë që të përcaktohet hapat që duhen ndjekur në procesin e zbatimit të strategjisë së veprimit të OSHC-ve dhe të përdorimit të burimeve natyrore, apo dhe konsolidimin e një modeli qeverisës, përmes mbështetjes ligjore, pjesëmarrjes dhe të interesave të komunitetit, të përbërë nga përfaqësues të ndryshëm.

Duke ndërmarr veprime zyrtare.

Nëse nga analiza kuptoni që sado të organizuar të mund të jeni nuk mund të sillni ndryshimin, atëherë mënyra më e mirë për të përdorur me efikasitet informacionin që keni është të nxisim vendimmarrësit të ndryshojnë politikat, administratën publike dhe bizneset që të ndryshojnë sjelljen.

Në rastet kur kërkimet tregojnë se nivelet ruajtjes dhe të përdorimit të mjedisit dhe të burimeve natyrore nuk janë të kënaqshme apo dhe shkojnë drejtë përkeqësimit është një mundësi e shkëlqyer për të ndërmarr veprime zyrtare, për t'i paraqitur tek drejtuesit vendor dhe kujtuar komunitetit se kjo situatë abuzimi do të jetë një çështje shqetësimi në vijimësi dhe se këto të dhënat duhet t'i përdorni për të sensibilizuar publikun si dhe për të ridrejtuar përpjekjet për këtë problem.

Procesi i përdorimit të informacionit në mënyrë strategjike për të ndryshuar mendësitë, politikat dhe legjislacionin përkatës, që kanë ndikim në jetën e komuniteteve, duhet e sjell doemos *“Ndryshimin e politikave, të legjislacionit dhe praktikave”*.

Ndër veprime të tjera OSHC-të duhet të hapin edhe çështje gjyqësore, për shkeljet penale ose administrative, pas denoncimit dhe kur ka të dhëna të mjaftueshme për të mbështetur akuzat kundër të krimit mjedisor dhe korrupsionit. Përpjekjet e OSHC-ve, për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit mbi pasojat e korrupsionit dhe dënimin e personave përgjegjës, mund të ndihmojnë në eliminimin e perceptimit të pandëshkueshmërisë nga ana e organeve përkatëse, tek publiku i gjerë.

Mjetet për veprimet zyrtare duhet të përfshijnë:

- a) Paraqitja e kërkesave për informacion dhe ndjekja e veprimeve të ndërmarra ndaj këtyre kërkesave.
- b) Ndjekja e politikave dhe kornizës ligjore që inkurajojnë aksesin në pjesët përkatëse të informacionit dhe edukimin e njerëzve se si t'i përdorin ato.
- c) Pjesëmarrja në takime publike ose ndjekja e proceseve për të vëzhguar ose kontribuar.
- d) Shpërndarja e lajmeve lokale në kohë reale që nuk janë kapur në media. Siguroni një platformë (online ose jopersonale) për akses publik në këto lajme.
- e) Organizoni diskutime në publik.

HAPI I PESTË: VAZHDIMI I MBIKËQYRJES PËR NJË KOHË TË GJATË.

Qëndrueshmëria është procesi aktiv i vijimit të nismës së mbikëqyrjes, jo thjesht vazhdim i programit tuaj, por zhvillim i marrëdhënieve, praktikave dhe procedurave që bëhen pjesë e qëndrueshme me komunitetin. Zhvillimi i një plani/strategjie për qëndrueshmërinë e nismës së mbikëqyrjes do të rrisë ndikimin dhe mbështetjen ndaj tij, pasi dhe qëllimi, në këtë rast, është të vijoni mbikëqyrjen, arritjen e objektivave, kryerjen e aktiviteteve përfituese afatgjatë për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të mjedisit dhe të burimeve natyrore.

Mbikëqyrja/Vëzhgimi mjedisore nuk duhet të përfundojë më arritjen e një marrëveshjeje, me fitim e një fushatë advokuese apo edhe me fitimin e një rasti në gjyqësor.

Një zgjidhje është një aspekt specifik i punës së organizatës apo/dhe rrjetëzimit si një proces pune që duhet ndërmarrë për të zgjidhur çështjen, apo si sfidë e veçantë. Kur dokumentoni zgjidhjen përpikuni të jeni specifikë për të siguruar të tjerët për të kuptuar dhe njohur punën tuaj.

Zgjidhjet i përgjigjen zhvillimit të qëndrueshëm, mirëqenies së komuniteteve dhe kontribuojnë në ruajtjen e mjedisit, ZMM, përmirësimin e biodiversitetit dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe peizazhit.

Zgjidhjet janë efektive kur zbatimi i tyre tregon një ndikim pozitiv të demonstruar në publik, tek njerëzit, komuniteti apo grupet e interesit.

Megjithatë, varësisht vullnetit dhe dëshirës së mirë për të nisur dhe vijuar mbikëqyrjen mjedisore, duhet të mbani në vëmendje se këto nisma kanë edhe një shkallë rrezikshmërie më të lartë se projektet e natyrave të tjera në lidhje me ruajtjen e mjedisit dhe të burimeve natyrore.

Në këtë kontekst, ndër rreziqet më të zakonshme mund të përmendim:

- ✓ Nevoja e OShC-ve për burime njerëzore për t'u angazhuar për një kohë të gjatë, sikundër kërkohet në këtë metodologji. Procesi dhe puna vëzhguese nuk përfundon asnjëherë, shpesh duhet të kaloj në një angazhim vullnetar të nismëtarëve, pas përfundimit të projektit.
- ✓ Kërcënimet, janë përherë problematik, kur ndodhin. Mbikëqyrësit duhet të jenë shumë të kujdesshëm, të besueshëm dhe të vlerësojnë shumë mirë rrezikun në nivel personal apo si organizatë përpara se t'a bëjnë çështjen publike. Po ashtu duhet të krijojnë aleancat e duhura, të konsoliduara dhe shumë të fuqishme me mekanizmat rajonale dhe ndërkombëtarë.
- ✓ Shpenzime të paparashikueshme, në çdo hap të mbikëqyrjes edhe pse ka një linjë logjike është i paparashikueshëm në varësi të gjetjeve. Në këtë mënyrë aktivitetet e ndërmarrë mund të dalin menjëherë dhe të pa planifikuara.
- ✓ Rastet e denoncuar në gjyqësor zgjaten dhe shpesh mund të mos përfundojnë pozitivisht, fatkeqësisht ka shumë të tilla në lidhje me keqpërdorimet e mjedisit dhe të burimeve natyrore, andaj këshillohet që çështja e mbikëqyrur dhe e bërë publike të zgjidhet pa e paraqitur në gjyqësor.

7. DREJTIMIT BAZË TË MBIKËQYRJES MJEDISORE NË NIVEL LOKAL

Është mirë të kuptohet se mbikëqyrja/vëzhgimi zakonisht është një proces afatgjatë, i cili ka logjikën e vet, përbëhet nga komponentë kryesorë dhe ndjek disa hapa/faza. Këto hapa mund të ndryshojnë në kohë dhe hapësirë, por është mirë të mbani mend se cilat janë gjërat kyçe për të identifikuar dhe punuar me to, kur jeni duke punuar për të arritur një ndryshim ose për të zhvilluar strategjinë e mbikëqyrjes.

Në këtë kontekst roli i OShC-ve apo i rrjetëzimeve lokale, edhe pse është rritur në mënyrë të ndjeshme nga viti në vit, ende nuk ka ndikimin e duhur në jetën publike dhe politike të vendit, në lidhje me mjedisin e natyrën si dhe për vlerësimin dhe promovimin e ruajtjes dhe të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Niveli i përmirësimit të bashkëpunimit mes OShC-ve me autoritetet shtetërore, të çdo niveli, pjesëmarrja aktive dhe cilësore në proceset legjislativë, të investigimit në zbatimin e legjislacionit, të strategjive, programeve apo/dhe planeve lokale të veprimit në mjedisi, si dhe duke pasur parasysh si nismat publike ashtu dhe ato private, ende është i dobët dhe jo rezultativ.

Shpesh roli dhe bashkëpunimi është i penguar nga mungesa e kapaciteteve të duhura dhe aftësitë e komunikimit ndërmjet OShC-ve, përfshi edhe komunitetin. Megjithëse janë dhe të rrjetëzuara dhe kanë përfituar një përvojë në këtë drejtim, ende kanë mangësi në adresimin e problematikave mjedisore, forcën jo të duhur për të ndikuar në vendimmarrje, në ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e komuniteteve në lëvizjet mjedisore.

Gjithashtu, programet e OShC-ve nuk janë të drejtuar dhe të bazuar në një vizion të planifikimit strategjik për rritjen e aftësive të tyre monitoruese dhe adresimin me forcë të problemeve që shqetësojnë sot dhe për nesër në nivel lokal dhe kombëtar, gjë e cila kërkon ndryshim thelbësorë në mënyrat e komunikimit dhe të marrëdhënieve të ndërsjella, në lidhje me promovimin e ruajtjes së natyrës dhe të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore.

INCA, në kuadër të projektit “Rrjetëzimi dhe Advokim për Aksione Komunitare të Ruajtjes së Burimeve Natyrore Lokale”, me mbështetjen financiare të LëvizAlbania, një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e shohin si domosdoshmëri rritjen dhe forcimin i rolit e të aftësive të OShC-ve në procesin ruajtjes së natyrës, të menaxhimit të ZMM, në zbatimin e ligjit, për të luftuar korrupsionin, duke ndërmarrë nisma dhe veprime të përbashkëta, që kanë për qëllim mbrojtjen, promovimin dhe menaxhimin e burimeve natyrore.

Në kuadër të aktiviteteve të këtij projekti INCA dhe parterët kryen identifikimin e problematikave mjedisore në nivel lokal, i cili shërben si një hap i rëndësishëm në hartimin e rekomandimeve politike dhe përcaktimin e ndërhyrjeve më të përshtatshme për të garantuar përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në nivel lokal.

Ky identifikim u krye nëpërmjet një metodologjie (pyetësori-anketues) të vlerësimit efektivë, pas trajnimit të kryer me anëtarët e rrjetëzimeve lokale dhe grupet e interesit. Procesi i identifikimit morri në konsideratë procesin e grumbullimit dhe analizimit të fakteve të mbledhura dhe tërheqjen e vëmendjes publike drejt problematikave kryesore me të cilat përballen sot mjedisi dhe burimet natyrore në të tri bashkitë.

Informacioni i siguruar krahason ndikimet aktuale dhe të ardhshme dhe mat në mënyrë sistematike eficientë dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjeve konkrete, përmes rezultateve dhe treguesve përkatës.

Vlerësimi i situatës aktuale ishte rezultat i takimeve dhe bashkëbisedimeve me OJF-të, komunitetin, palët e tjera të interesuara, biznesin, përdorues, individët, punonjës të administratës publike vendore dhe të administratës së zonës të mbrojtur (AdZM). Po kështu edhe i investigimeve në terren, ku nëpërmjet tyre u siguroa një pamje e përgjithshme të problemeve ekzistuese dhe potenciale në mjedis, të cilat kanë ndikim në biodiversitet, ekosisteme, peizazh, burimet natyrore dhe në zhvillimin vendor social-ekonomik.

Veç kësaj anketimi ndihmojë organizatat mjedisore të grupuara në rrjete lokale për mbrojtjen e natyrës dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në grumbullimin e informacioneve të nevojshme për identifikimin dhe prioritizimin e problematikave lokale, si hap i parë në adresimin dhe zgjidhjen e tyre, në 1. Bashkia Divjakë dhe Njësitë Administrative (Divjakë, Grabian, Gradishtë, Remas dhe Tërbuf). 2. Bashkia Has dhe Njësitë Administrative (Fajzë, Gjinaj, Golaj dhe Krumë). 3. Bashkia Lezhë dhe Njësitë Administrative (Balltren, Blinisht, Dajç, Kallmet, Kolsh, Lezhë, Shëngjin, Ungrej dhe Zejmen).

7.1 ANALIZA E TË DHËNAVE TË PYETËSORIT

Seksioni I: Të dhënat të përgjithshme

#Për pyetjen 1: Cilës grupmoshe i përkisni?

Duke iu referuar të dhënave të pyetësorit-anktetues (për të tri bashkitë) kanë shprehur mendimet apo pikëpamjet e tyre, Gjithsej **370 të intervistuar**, nga të cilët: 115 (31.1%) të grupmoshës 15-25 vjeç; 110 (29.7%) të grupmoshës 26-40 vjeç; 84 (22.7%) të grupmoshës 41-55 vjeç; 46 (12.4%) të grupmoshës 56-65 vjeç dhe 15 (4.1%) të grupmoshës mbi 65vjeç.

#Për pyetjen 2: Cilës gjini i përkisni?

Nga anketuesit rezultojnë se: 173 (46.8%) i përkasin gjinisë Mashkull dhe 197 (53.2%) gjinisë Femër.

#Për pyetjen 3: Arsimimi.

Nga anketuesit rezultojnë se: 180 (48.6%) i përkasin arsimit të mesëm, 143 (38.6%) arsimit të lartë, 35 (9.5%) arsimi bazë dhe 12 (3.2%) arsimi profesional.

#Për pyetjen 4: Përkatësia institucionale/individuale.

Në lidhje me përkatësinë personale apo institucionale rezultojnë se: 206 (55.7%) janë individë; 87 (23.5%) nga administrata publike; 51 (13.8%) privat dhe 26 (7%) nga OJF-t.

#Për pyetjen 5: Profesionimi.

Nga të dhënat e pyetësorit për të tri bashkitë vërehet se kanë marr pjesë: Mësues, Nxënës, Student, Biznesmen, Fermer, Agronom, Infermier, Tregtar, Ekonomist, Financiar, Llogaritar, Jurist, Polic, Punonjës social, Psikolog, Inxhinier e Teknik pyjesh, Inxhinier ndërtimi dhe kompjuterik, Biolog, Veteriner, Zooteknik, Peshkatar, Farmacist, Parukjere, Agroturizëm,

Specialist ndërtimi, Hidraulik, Elektricist, Banakier, Kuzhinier, Emigrant, Menaxher, Të papunë, Pensionit, Mekanik, OJF.

Seksioni II: Vlerat natyrore dhe përfitimet nga burimet natyrore

#Për pyetjen 1: Cilat janë vlerat më të rëndësishme mjedisore e natyrore në bashkinë tuaj?

Nga të dhënat e pyetësori për të tri bashkitë rezulton se prej anketuesve janë shprehur për: 319 (86.2%) Peizazhi natyror; 206 (55.7%) Fauna e egër; 200 (54.1%) Burimet ujore; 129 (34.9%) Bimët mjekësore; 53 (14,3%) Minerale dhe burimet e tjera nëntokësore dhe 8 (2.3%) Flora, pemët dekorative, ujërat.

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: ccc

Çfarë duhet në këtë drejtim”?

Shembuj: OShC si një vëzhgues lokal, duhet të luaj rolin për njohjen dhe promovimin e vlerave më të rëndësishme mjedisore e natyrore që gjenden në territorin e bashkisë, nëpërmjet studimeve, vlerësimeve dhe organizimit të takimeve me stafin e bashkisë, përdoruesit, përfituesit dhe komunitetin, të publikimeve dhe organizimit të veprimtarive ndërgjegjësuese, edukuese, social-ekonomike, ekoturistike dhe agroturizmit.

#Për pyetjen 2: Cilat janë përfitimet më të rëndësishme social-ekonomike dhe ekoturistike që territori i bashkisë ofron për komunitetin lokal?, rezulton:

Nga të dhënat e pyetësori për të tri bashkitë anketuesit janë shprehur: 310 (83.8%) Bujqësia; 260 (70.3%) Turizmi; 198 (53.5%) Blegtoria dhe Kullotat; 140 (37.8%) Peshkimi; 123 (33.2%) Ekoturizmi; 11 (3%) Turizmi historik; 10 (2.7%) Bimët endemike; 8 (2.2%) Bimët mjekësore; 1 (03%) Tregtia dhe 1 (0.3%) Burime të tjera.

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: ccc

Çfarë duhet në këtë drejtim”?

Shembuj: Përdorimi racional i burimeve natyrore është një nga problemet më të rëndësishme të komuniteteve. Aktualisht, problemi i varfërimit të burimeve natyrore po bëhet gjithnjë e më i mprehtë. Shkatërrimi i potencialit të burimeve natyrore shprehet në pakësimin e tyre në një nivel që nuk plotëson nevojat e komuniteteve.

Kjo dhe për faktin se komunitetet lokale, në shumicën e rasteve, nuk arrijnë të prekin përfitimet socio-ekonomike që rrjedhin nga menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore. Mos përfshirja dhe ndarja jo e drejtë e përfitimeve vjen përgjithësisht si pasojë e kapaciteteve të ulëta dhe mungesës së njohurive në grupet e komunitetit lokal.

OShC si një vëzhgues lokal, duhet të luaj rolin për njohjen e përfitimeve dhe të rëndësisë social-ekonomike, ekoturistike dhe agroturizmit që ka komunitetit dhe biznesi, përmes përdorimit të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të përfitimeve social-ekonomike dhe ekoturistike që ofron territori i bashkisë, duke organizuar debate dhe veprimtari publike, përfshirë stafin e bashkisë dhe palët e tjera të interesuara.

#Për pyetjen 3: Sa e rëndësishme është ruajtja e mjedisit natyror në bashkinë tuaj?, rezultoni:

Nga të dhënat e pyetësori për të tri bashkitë anketuesit janë shprehur: 261 (70.5%) Shumë e rëndësishme; 83 (22.4%) Disi e rëndësishme; 22 (5.9%) Nuk është e rëndësishme dhe 4 (1.1%) kanë Refuzuar.

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: ccc

Çfarë duhet në këtë drejtim”?

Shembuj: Vërehet se problematika mjedisore nuk konsiderohet ende të rëndësishme në hartimin e politikave zhvillimore social-ekonomike në nivelin lokal. Aktualisht, kjo situatë pengon zbatimin efektiv të politikave të ruajtjes dhe të përdorimit të burimeve natyrore, dhe lehtësisht çon në konflikte dhe keqkuptime, veçanërisht me komunitetet lokale.

OShC si një vëzhgues lokal, *së pari* përmes studimeve e vëzhgimeve duhet të identifikoj dhe të publikoj rëndësinë që ka ruajtja e mjedisit natyror me gjithë komponentët e tij, për komunitetin, biznesin, palët e interesuara dhe më gjere; *së dyti* duke vërejtur se ruajtja e mjedisit ka ende mjaft problemet, të organizoj takime të shpeshta me strukturat përkatëse të bashkisë, specialistë dhe me institucionet monitoruese e ligj zbatuese të mbrojtjes së mjedisit, të planifikimit e zhvillimit të territorit dhe përdoruesit e mjedisit natyror, duke ngritur zërin dhe paraqitur argumente që problematika mjedisore të përfshihen në hartimin e politikave lokale.

Po ashtu dhe për zbatim të plotë të legjislacionin në fuqi, duke denoncuar rastet e dëmtimit apo tjetërsimit të mjedisit natyror, të moszbatimit të kompetencat apo dhe detyrës nga strukturat përkatëse.

#Për pyetjen 4: A ka plan veprimi për mjedisin të miratuar në bashkinë tuaj?, rezulton:

Nga të dhënat e pyetësores për të tri bashkitë janë shprehur: 220 (59.5%) Nuk e di; 123 (33.2%) anketues PO dhe 27 (7.3%) JO.

Për pyetjen Si është zbatuar përgjigjen: 90 (44.8%) Mirë; 52 (25.9%) Shumë mirë; 22 (10.9%) Mjaftueshëm dhe 37 (18.4%) Nuk është zbatuar.

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: ccc

Nëse PO, si është zbatuar?

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: ccc

Çfarë duhet në këtë drejtim”?

Shembuj: Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore ende nuk është i integruar sa e si duhet në politikën lokale.

Politikat dhe strategjitë sektoriale për mjedisin mungojnë ose duhet të përditësohen për ti integruar me politikën e BE-së. Në këtë aspekt vërehet se në faqet zyrtare të bashkive nuk ka informacion në lidhje me Planin Lokal të Veprimit Mjedis. Kësisoj një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve, ka gjasa që nuk kanë dijeni të plotë për këtë fakt ose e ngatërrojnë me Planin e Përgjithshëm Vendor.

OSHC-ja, duhet të ndërmarrë veprime konkrete pranë organe kryesore dhe përgjegjëse të bashkisë, për të verifikuar dhe vlerësuar nëse është hartuar Plani Lokal i Veprimit për Mjedisin (PLVM), si është zbatuar në praktike dhe a është analizuar në Këshillin Bashkiak, në zbatim të nenit 22, të ligjit “Për mbrojtjen e Mjedisit”, të ndryshuar.

Sipas kësaj dispozite ligjore ti kërkohet autoritetit të qeverisjes vendore përgatitjen e PLVM në mënyrë periodike.

Në këtë drejtim OSHC-ja mbikëqyrëse nuk duhet të ngatërroj Planin e Përgjithshëm Vendor

(PPV) me PLVM.

Gjithashtu OSHC-ja mbikëqyrëse duhet të kontrollojë nëse Këshilli i Autoritetit të qeverisjes vendore përkatëse ka miratuar këtë plan dhe nëse Po, sa herë është analizuar. Në të kundër duhet të llojë pranë Kryetarit të Këshillit Bashkiak që të ndërhyjë pranë Kryetarit të bashkisë për hartimin e PLVM.

Po ashtu duhet të verifikojë nëse Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, në fillim të çdo viti, raporton në Këshillin e Qarkut për zbatimin e planeve vendore përkatëse për mjedisin, për vitin pararendës.

#Për pyetjen 5: A mendoni se problemet mjedisore janë prioritare në politikën vendore?, rezultoni:

Nga të dhënat e pyetësi për të tri bashkitë janë shprehur: 137 (37%) Janë prioritare; 100 (27%) Janë konsideruar prioritare; 102 (27.6%) Janë pak prioritare dhe 31 (8.4%) Nuk janë prioritare.

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: ccc

Çfarë duhet në këtë drejtim”?

Shembuj: Vërehet se problematika mjedisore nuk konsiderohet ende të rëndësishme dhe si prioritet në hartimin e politikave zhvillimore social-ekonomike në nivelin lokal.

OSHC-ja duhet të mbledhë dhe analizoj dokumentet, programet, planet zhvillimore, të menaxhimit dhe të veprimit në mjedis, projektet për burimet natyrore dhe zonat e mbrojtura, raportet, analizat dhe çdo informacion përkatëse në lidhje me problematika mjedisore dhe të burimeve natyrore në nivel vendor.

OSHC-ja si një vëzhgues lokal, duhet të mbikëqyri dhe hetojë nëse vërtetë janë prioritare në politikën vendore problemet e mjedisit dhe të administrimit të burimeve natyrore dhe nëse ato janë kryer sipas standardeve të pranura ligjore, etike dhe profesionale.

Hetimi duhet të përqendrohet dhe të kontrollohet se si është hartuar dhe zbatuar program i transparencës, i llogaridhënies dhe antikorrupsion në bashki.

Verifikoni sa herë janë analizuar nga bashkia dhe Këshilli Bashkiak (KB) problemet mjedisore, cili është raporti dhe konkluzionet e analizave të kryera, cilët kanë qenë vendimet përkatëse dhe se si janë zbatuar ato; nëse ky prioritet a është përfshirë në planet dhe programet vjetore të punës së bashkisë dhe të KB apo/dhe në Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV), etj.

Për këtë mund të përdorni edhe Platformë Kombëtare ku publikohen vendimet e këshillave bashkiakë të Republikës së Shqipërisë (VENDIME.AL).

#Për pyetjen 6: A organizohen takime nga administrata e bashkisë për çështjet e ruajtjes dhe administrimit të burimeve natyrore?, rezulton:

Nga të dhënat e pyetësores për të tri bashkitë janë shprehur: 95 (25.7%) Një herë në vit; 60 (16.2%) Dy herë në vit; 110 (29.7%) Takime të shpeshta dhe 105 (28.4%) Asnjëherë.

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për:
aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: ccc

Çfarë duhet në këtë drejtim”?

Shembuj: Vërehet se stafit përkatës në bashki shpesh i mungojnë përvoja, shkëmbimi i njohurive, mundësia e financimeve dhe hasin shumë sfida të tjera gjatë punës së tyre të përditshme, që lidhen, por që nuk duhet të kufizohet me zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme përmes edhe takimeve me komunitetin, palët e interesuara, OSHC-të, biznesit dhe përdorues të burimeve natyrore.

Në nivel vendor, bashkëpunimi me OJF-të kryesisht përqendrohet në veprime dhe projekte konkrete, ndërjegjësimi mjedisor.

OSHC-ja si një vëzhgues lokal, duhet të mbikëqyri dhe hetojë nëse vërtetë janë organizuar takime nga administrata e bashkisë, sipas përkatësisë, për çështjet e ruajtjes dhe administrimit të burimeve natyrore, duke përfshirë pyjet, kullotat, prodhimet e dyta pyjore, bimët mjekësore, gjuetinë, peshkimin, etj.

Hetimi duhet të përqendrohet dhe të kontrollohet nëse ka plane pune të administratës për këtë qëllim, cilat kanë qenë konkretisht takimet, çfarë problematika janë evidentuar dhe cilët kanë qenë masat e propozuar për përmirësimin e gjendjes, dhe si janë zbatuar ato në lidhje me administrimin e burimeve natyrore.

#Për pyetjen 7: Cili është mendimi juaj për punën e strukturave të bashkisë në lidhje me çështjet e ruajtjes dhe administrimit të burimeve natyrore?, rezulton:

Nga të dhënat e pyetësores për të tri bashkitë janë shprehur: 43 (11.6%) Shumë mirë; 131 (35.4%) E mirë; 63 (17%) E mjaftueshme; 91 (24.6%) E dobët dhe 42 (11.4%) Nuk e di/Nuk kam informacion.

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për:
aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për:
ccc

Çfarë duhet në këtë drejtim”?

Shembuj: Nga përvoja e deri tashme menaxhimi institucional lë për të dëshiruar dhe vihen re abuzime të konsiderueshme. Shpesh janë gjendur mekanizma për të anashkuar kuadrin ligjor dhe për të vazhduar shfrytëzimin tejskajshëm të burimeve natyrore, veçanërisht të pyjeve, kullotave, bimëve mjekësore, të gjuetisë, peshkimi, ujërave, etj., apo të një zhvillimi jo të qëndrueshëm, në disa raste kaotik, si rrjedhojë edhe të strukturave të dobëta administrative, të mos zbatimit të detyrave, përgjegjësisë, të mos njohjes së kompetencave apo/dhe të lëvizjeve të shpeshta të specialistëve.

OSHC-ja në rolin e mbikëqyrësit duhet të ushtroj mbikëqyrjen se si është funksionimi i strukturave përgjegjëse në bashki, në lidhje me çështjet e ruajtjes dhe administrimit të burimeve natyrore.

Njëherazi, në zbatim të dispozitave të ligjit “Për Pyjet”, OSHC-ja mbikëqyrëse verifikon dhe bën publike nëse janë ngritur dhe si funksionojnë struktura përgjegjëse për qeverisjen e pyjeve në bashki dhe struktura komunitare në fshat që kujdesen për përdorimin e qëndrueshëm të pyjeve në fshat, në përputhje me nevojat dhe politikat për zhvillimin e zonave rurale.

OSHC-ja mbikëqyrëse verifikon nëse strukturat përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki kanë hartuar planet e përmirësimit të fondit pyjor që kanë nën administrim; planet 10-vjeçar të mbarështimit dhe të inventarizimit të kullotave, sipas ligjit “Për fondin kullor”; planet e mbarështimit dhe të inventarizimit të fondit të bimëve mjekësore dhe eterovajore (çdo 5 vjet), dhe nëse çdo fillim viti bashkia ka miratuar a) zonat ku do të vilen e mblidhen këto bimë; b) afatet dhe kalendarin e vjeljes për secilin lloj; c) llojet që do të vilen, mblidhen e grumbullohen, në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore”.

Hetimi duhet të evidentoj dhe të bëhet publik dobësitë administrative, mungesë e politikave integruese dhe të burimeve financiare; të abuzimeve dhe korrupsionit në zbatimin e përgjegjësisë dhe të detyrimeve ligjore, në vazhdimin e shfrytëzimit pa kriter të burimeve natyrore, veçanërisht të pyjeve, kullotave, bimëve mjekësore, faunën e egër dhe peshkimit.

Gjithashtu të mbikëqyret se cili është niveli edhe bashkëpunimi mes institucioneve administruese e ligj zbatuese në nivelin vendor që përbën pikën më kritike të problematikës mjedisore dhe të synohet të ndërtohet një platformë bashkëpunimi mes tyre.

#Për pyetjen 8: A jeni përfshirë në aktivitete ku janë prezantuar/faktuar/diskutuar problematikat mjedisore?, rezulton:

Nga të dhënat e pyetësores për të tri bashkitë janë shprehur: 76 (20.5%); Po, kam marr pjesë aktivisht; 59 (15.%) Kam marr pjesë, por nuk kam qenë aktiv; 55 (14.9%) Kam pasur dijeni për aktivitetin, por nuk kam qenë aktiv; 180 (48.%) Nuk kam marr pjesë.

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për:
aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për:
ccc

Çfarë duhet në këtë drejtim”?

Shembuj: Shpesh herë përfshirja në aktivitete, ku bëhet prezantimi apo diskutimi rreth problematikave mjedisore, është jo e kënaqshme, nuk përbënë një vijimësi dhe motivim të OSHC-ve e të rrjetëzimeve të tyre, për sa nuk kanë projekte. Përfshirja kryhet vetëm në raste të projekteve të dedikuara. Si nga individët, por dhe nga OSHC-të, ende nuk vërehet ndikimi i duhur në jetën publike dhe politike, në lidhje me mjedisin e natyrën, si për vlerësimin dhe promovimin e ruajtjes dhe të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore. Ka mungesë të pjesëmarrjes aktive në proceset e zbatimit të legjislationit, të strategjive, programeve apo/dhe planeve lokale të veprimit në mjedisi.

OSHC-ja në rolin e mbikëqyrësit duhet të ndërtojë strategji dhe plan veprimi për thellimin e rolit të bashkëpunimit, të rritjes së kapaciteteve, të aftësive të komunikimit me rrjetëzimet përkatëse, përfshirjen e komuniteteve dhe të individëve në proceset monitoruese dhe në adresimin me forcë të problemeve që shqetësojnë ruajtjen e natyrës dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

#Për pyetjen 9: Si OJF, a Ju kërkojnë mendimin tuaj mbi çështjet në lidhje me aktivitetet mjedisore që zhvillon bashkia juaj?, rezultoni:

Nga të dhënat e pyetësores për të tri bashkitë janë shprehur: 309 (83.5%) Po dhe 61 (16.5%) Jo.

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për:
aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për:
ccc

Çfarë duhet në këtë drejtim”?

Shembuj: Qartazi vërehet se mjaft OShC-të janë të vogla, kanë mangësi organizative, mungesë të kushteve të punës, të menaxhimit të problemeve financiare, nuk janë aktive gjatë gjithë kohës, ende nuk kanë qëndrueshmërinë e pritshme, kanë mangësi në adresimin e problematikave mjedisore dhe jo forcën e duhur për të ndikuar në vendimmarrje, në ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e komuniteteve në lëvizjet mjedisore. etj.

OShC-ja dhe rrjetëzimi i tyre lokale duhet të kuptojnë, zbatojnë dhe të kërkojnë që e drejta mjedisore është tërësia e normave ligjore që rregullon marrëdhënien e njeriut me mjedisin. Njëherazi dhe e drejta e qytetarëve për t'u informuar mbi gjendjen e mjedisit dhe detyrimi për mbrojtjen e tij.

Stafi i bashkive e ka për detyrë dhe duhet të organizojë më shumë takime me OSHC-të që merren me mjedisin, natyrën dhe biodiversitetin, pasi do të ndihmonin njëra-tjetrën në realizimin e fushatave të ndryshme ndërgjegjësuese për promovimin dhe mbrojtjen e natyrës, me aktorët dhe përdoruesit e burimeve natyrore.

OShC-ja duhet të organizojë debate publike, ku komuniteti dhe biznesi të njoftohen për punën e kryer nga institucionet përgjegjëse në nivel vendor për mbrojtjen e natyrës, biodiversitetit, peizazhit dhe mbi përdorimin e burimeve natyrore, përmes veprimtarive të edukimit e ndërgjegjësimin, gjë që do të ndikonin në vetëdijesimin institucioneve dhe të komunitetit për të marrë përgjegjësi dhe për të dhënë kontribut në ruajtje të natyrës.

OShC-ja mbikëqyrëse, duhet të ndjekë dhe të bëjë publik se si zbatohen nga organet përkatëse procedurat ligjore në lidhje me konsultimin me grupet e interesit dhe OSHC-të për çështjet që do të trajtohen në raportin e VNM-së apo/dhe VSM-së, si duhet të përfshihet në konsultime e diskutime për projekt-strategjitë, Project-ligjet, në grupe të punës ose takimeve të tjera, të organizuara nga autoritetet publike.

Gjithashtu, OSHC-ja, për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejt ose jo, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre, medoemos duhet të kërkojë apo të marrë pjesë në seancat dëgjimore publike të organizuar nga autoritete publike, duke dhënë kontributi dhe mendimet përkatëse.

Po ashtu OSHC-ja në rolin e mbikëqyrësit duhet të ndjekë dhe të bëjë publike masat përkatëse për zbatimin e mbrojtjes së natyrës, pyjeve, kullotave, ujërave, bimëve mjekësore, florës dhe faunës së egër, etj.

Seksioni III: Ligjshmëria – njohja dhe zbatimi

#Për pyetjen 1: Cili është mendimi juaj për zbatimin e ligjshmërisë në lidhje me ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve natyrore në bashkinë tuaj?, rezultoni:

Nga të dhënat e pyetësori për të tri bashkitë janë shprehur: 41 (11.1%) Shumë mirë; 130 (35.1%) I mirë; 67 (18.1%) Mjaftueshëm; 84 (22.7%) I dobët dhe 48 (13%) Nuk e di.

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për:
aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: ccc

Pavarësisht të dhënave të pyetësorit ende vërehen mangësi në njohja dhe zbatimin e legjislacionit ekzistues për ruajtjen e natyrës dhe të burimeve natyrore, i cili duhet të vijojë, duke forcuar dhe përmirësuar kontrollin e praktikave të jashtëligjshme në nivel vendor, me ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e ndërlidhshmërisë së habitateve natyrore, të popullatave të specieve të rrezikuara, të veprimtarive si gjuetia dhe peshkimi i jashtëligjshme, prerja pa kriter e pyjeve, përdorimi i kullotave, shfrytëzimi i bimëve mjekësore dhe i burimeve të tjera natyrore të ripërtëritshme apo/dhe jo të ripërtëritshme.

Ligjet apo rregullat aktuale janë një shprehje e politikës zyrtare, shpesh e shkaktuar nga reagimi i publikut. Ndryshimet në politikën zyrtare, që shpesh në ndryshime në ligje apo/dhe rregullore, janë gjithashtu të motivuara nga interesat dhe ndikimet që kanë në zhvillimin social, ekonomik e mjedisor dhe në të ardhurat e publikut e të palëve të interesit.

Çfarë duhet në këtë drejtim”?

Shembuj: Në përgjithësi legjislacionit mjedisor në Shqipëri është frymëzuar dukshëm nga standardet e BE-së, ku parimet kryesore mbi mjedisin janë përfshirë. Masat për mbrojtjen e natyrës, biodiversitetit, ZMM, peizazhet dhe burimet natyrore duhet të jenë pjesë e rëndësishme e politikave qendrore, rajonale e lokale të zhvillimit, me qëllim që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm, bazuar në një marrëdhënie të balancuar e në harmoni midis nevojave sociale, veprimtarive ekonomike dhe mjedisit dhe trashëgimisë natyrore.

Me gjithë përpjekjet e bërë në kornizën ligjore, në aspektin e mbrojtjes së natyrës dhe shumëllojshmërisë biologjike e peizazhore, duhet të pranojmë, se ka ende boshllëqe në plotësimin dhe zbatimin e tyre. Kjo situatë ka krijuar konfuzion edhe në lidhje me vendosjen e përgjegjësisë dhe kompetencave përkatëse.

OSHC-ja mbikëqyrëse, ndjek dhe verifikon nëse është përmirësuar përputhshmëria me standardet mjedisore ndërkombëtare dhe procedurat për leje që lidhen me ndikimin e projekteve të infrastrukturës, impiante energjetike, nxjerrja e lëndëve minerare, etj., në biodiversitet, peizazh dhe burimet natyrore; pasi zbatimin e kërkesave ligjore ofron mbështetje të mëtijshme edhe në proceset e politikë-bërjes dhe vendimmarrjes, kryesisht të nivelit lokal.

OSHC në rolin e vëzhguesit lokal mund të monitoroj dhe hetoj strukturat e qeverisjes vendore, bizneset dhe institucionet të tjera, praktikave, procedurat, politikave dhe/ose programet për të përcaktuar nëse janë ato që pritet të jenë, dhe nëse janë kryer sipas standardeve ligjore, etike dhe profesionale.

Po ashtu OSHC-ja duhet të ndjekë dhe analizoj hollësisht kornizën kombëtare rregullatore të pjesëmarrjes së publikut, të drejtën për informim dhe luftimin e korrupsionit në përdorimin e burimeve natyrore dhe ZMM-ve si dhe procesin e menaxhimit të tyre.

#Për pyetjen 2: A ka raste të dukurive të korrupsionit dhe krimit mjedisor në administrimin dhe përdorimin e burimeve natyrore në bashkinë tuaj?, rezultoni:

Nga të dhënat e pyetësores për të tri bashkitë janë shprehur: 266 (71.9%) Jo dhe 104 (28.1%) Po.

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: ccc

Cfarë duhet në këtë drejtim”?

Shembuj: OShC-ja dhe rrjetëzimeve të tyre lokale ku përfshihet mbikëqyrja e zbatimit të kuadrit ligjor, duhet të hetojnë nëse ligjet dhe rregulloret janë zbatuar rreptësisht, apo vërehen veprime korruptive në lidhje me mjedisin dhe burimet natyrore, apo për krijimin dhe përshtatjen e politikave e procedurave që zbatohen ose japin efekt mbi legjislacionin apo/dhe ndryshimet në legjislacionin ekzistues.

Njëherazi duhet përfshirë edhe reagimi ndaj zbatimit të ligjit, të boshllëqeve të zbatimit, duke kërkuar bashkëpunimin me anëtarët e sistemit ligjor për të krijuar procese, procedura dhe programe të reja.

#Për pyetjen 3: Identifikoni se cilët janë problemet me ndikim negativ, që dëmtojnë mjedisin, natyrën, biodiversitetin dhe peizazhin në bashkinë tuaj duke vlerësuar dhe riskun potencial të tyre?, rezultoni:

Nga të dhënat e pyetësores për të tri bashkitë janë shprehur: ...

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: ccc

#Për pyetjen 4: Cilët janë shkaqet/ shkaktarët kryesorë të ndikimeve negative të mjedisit në bashkinë tuaj?, rezultoni:

Nga të dhënat e pyetësores për të tri bashkitë janë shprehur: ...

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: ccc

Çfarë duhet në këtë drejtim”?

Shembuj: OSHC-ja mbikëqyrëse pasi të ketë identifikuar se cilët janë problemet me ndikim negativ, që dëmtojnë mjedisin, natyrën, biodiversitetin, peizazhin dhe përdorimin e burimeve natyrore (të ripërtëritshme dhe jo të ripërtëritshme), vlerësoar riskun potencial të tyre dhe shkaqet/shkaktarët kryesore të ndodhjes, mbi bazën e tyre dhe të metodologjisë së “Mbikëqyrjes” (Watchdoggin) harton strategjinë e advokimit e lobimit, te përfshirjes së komunitetit e qytetareve dhe të komunikimit me mediat për reagimet ndaj qeverisjes vendore apo dhe asaj qendrore.

#Për pyetjen 5: Nga lista e problematikave të identifikuara më parë përcaktoni 2 problematika më prioritare në mjedis dhe burimet natyrore të cilat duhen bërë prezent në strukturat e bashkisë apo/dhe në autoritetet e tjera shtetërore në nivel lokal, rezulton: Nga të dhënat e pyetësori për të tri bashkitë janë shprehur: ...

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: ccc

#Për pyetjen 6: A ka zona të mbrojtura, që përfshihen në territorin e bashkisë tuaj?, rezulton:

Nga të dhënat e pyetësori për të tri bashkitë janë shprehur: 277 (74.9%) Po dhe 93 (25.1%) Jo.

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: ccc

#Për pyetjen 7: Cilat janë problematikat me cilat ndeshen Zonat e Mbrojtura?, rezulton:

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për:
aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: ccc

Seksioni IV: Edukimi dhe ndërgjegjësimi – Promovimi i vlerave natyrore

#Për pyetjen 1: A zhvillohen aktivitete ndërgjegjësuese dhe edukuese në zonën tuaj për promovimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore?, rezulton:

Nga të dhënat e pyetësori për të tri bashkitë janë shprehur: ...

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për:
aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: ccc

#Për pyetjen 2: Sa janë trajtuar në mediat lokale problematikat e menaxhimit të mjedisit dhe të burimeve natyrore?, rezulton:

Nga të dhënat e pyetësori për të tri bashkitë janë shprehur: 131 (35.4%) Po; 66 (17.8%) Jo dhe 173 (46.8%) Nuk e di.

Bashkia Has, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për:
aaa

Bashkia Divjakë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: bbb

Bashkia Lezhë, kanë dhënë mendim Nr.XX anketues, nga të cilët XX ose xx% shprehen për: ccc

Nga të dhënat e pyetësori për të tri bashkitë janë shprehur: 50 (13.5%) Shumë;140 (37.8%) Mjaftueshëm; 105 (28.4%) Pak; 30 (8.1%) Aspak dhe 45 (12.2%) Nuk e di.

#Për pyetjen 3: Listoni disa nga problematikat që janë trajtuar në mediat lokale/kombëtare

Nga të dhënat e pyetësores për të tri bashkitë janë shprehur:..

8. DOKUMENTA TË KËSHILLUAR

- Manual për Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrjen Mjedisore – Qendra Rajonale e Mjedisit (REC).
- Raport për njohjen, analizimin dhe përafrimin e legjislacionit të fushës së natyrës në Shqipëri. INCA.
- Vlerësimi i gjendjes së problematikave mjedisore dhe të zonave të mbrojtura në Shqipëri, INCA.
- Analiza e vlerësimit të nevojave të kuadrit rregullator kombëtar me rëndësi për burimet natyrore, përdorimit të zonave të mbrojtura, menaxhimit dhe procesit të vendimmarrjes. INCA.
- Doracak për ndikim në politikat e ruajtjes së natyrës përmes advokim-lobimit efektiv. INCA.
- Fushatbërja e efektshme – si të organizojmë një fushatë të suksesshme mjediore – manual i përgatitur për OJF-të nga Milieukontakt.
- Vigjilenca mjedisore në praktikë – Udhëzues për organizatat e shoqërisë civile, EDEN.
- Vlerësimi pasuror i krimeve mjedisore në Shqipëri. EcoAlbania.
- Manuali “Menaxhimi i Problemeve Mjedisore në Nivel Vendor” nga Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QShKE).
- Vlerësimi Mjedisor në Shqipëri pas Konfliktit. UNEP.
- The Critical Friend: An Effective Local Watchdog. Kageni, A. Reisdorf K.
- <https://ctb.ku.edu/en/table-of-contents/advocacy/advocacy-research/act-as-watchdog/main>.
- <https://advocacyguide.icpolicyadvocacy.org/>
- <http://www.who.int/workforcealliance/knowledge/toolkit/33.pdf>.